

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXI i botimit, nr. 238, Gusht 2023

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

NJOFTIM!

Anëtarë të Kryesisë së Shoqatës Atdhetare "Dukagjini". Në bazë të Statutit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", neni 11 "Strukturat drejtuese, përbërja dhe kompetencat e tyre", pika 3, germa a) "Konferenca zgjedhore e shoqatës mbledhet një here në pesë vjet...". Prandaj, Konferenca e VII e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" do të zhvillojë punimet e saj me datën 23 shtator 2023, ditë e shtune, në ora 11.00, në mjediset e bibliotekës së Universitetit "Luigj Gurakuqi", në Shkodër.

Konferenca e Shoqatës do të zhvillojë punimet me këtë renditje:

I-1-Paraqitja e realizimeve në periudhën pesë vjeçare, shtator 2018- shtator 2023, diskutime dhe miratime, Kryetari i SHAD, Ndue Sanaj;

2-Paraqitje e veprimtarisë financiare

për periudhën 2018-2023, diskutime e miratime, N/Kryetari i SHAD, z. Agron Hasanaj;

II-2-Zgjedhjet e strukturave drejtuese të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Komisioni zgjedhor:

a) Zgjedhja e Kryetarit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini";

b) Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini";

Në një kohë të më vonshme, por jo më shumë se 10 ditë, mbledhet Këshilli i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", i cili zgjedh Kryetarin, N/Kryetarin e sekretarin e saj dhe pastaj, me propozim të Kryetarit të SHAD, zgjedh anëtarët e Kryesisë së Shoqatës, me votim të hapur.

Kryesia e Re e SHAD, në mbledhjen e pare të saj, zgjedh:

• N/Kryetarin e SHAD;

- N/kryetarin për veprimtaritë e SHAD;
- N/Kryetarin, për ekonominë e financën e SHAD;
- Kryetarin e Seksionit të Financës e ekonomisë së SHAD;
- Kryetari e Seksionit për historiografinë në SHAD;
- Kryetarin e Seksionit për veprimtaritë e SHAD;
- Kryetarin e Seksionit për veprimtaritë kulturore;
- Kryetarin e Seksionit për veprimtaritë artistike;
- Kryetarin e Seksionit për veprimtaritë me shkollat;
- Kryetarin e Seksionit për veprimtarinë me Rininë;
- Kryetarin e Seksionit për veprimtarinë me librin;
- Kryetarin e Seksionit për projektet;
- Kryetarin e Seksionit për Median;
- Redaksinë e gazetës dhe miraton Kryeredaktorin e saj.

Shënim:

Zgjidhja e Kryetarit:

Kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", zotit Ndue Sanaj i ka mbaruar mandati dhe nuk do të jetë më kandidat për Kryetar të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini".

Ftojme anëtar e anëtare të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" të shpallin kandidaturën për Kryetar të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" brenda datës 15 shtator 2023, pranë Kryesisë së SHAD, i cili në bazë të vendimi të marrë në Konferencën e VI të SHAD, në muajin tetor 2018, Kandidati për Kryetar të SHAD, duhet të ketë një jetë në Shoqatën Atdhetare "Dukagjini", jo më pak se dhjetë vite.

**KRYESIA E SHOQATËS
ATDHETARE "DUKAGJINI"**

Shën Nënë Tereza - Nëna e Dashurisë, dritë për Botën 2

Shën Nënë Tereza lindi në Shkup më 26 gusht të vitit 1910 dhe kaloi në amshim më 5 Shtator 1997 në Kalkuta të Indisë. Nëpërmjet dashurisë për Krishtin dhe njeriun ajo arriti të pranohej nga njerizimi si Nënë e Dashurisë, prandaj dhe u nderua me çmimin Nobel për Paqen. Me 19 Tetor 2003 nga Papa Gjon Pali i II Nënë Tereza shpallet e Lume. Me 5 shtator të 2016 nga Papa Françesku në Vatikan u shpall Shën Nënë Tereza

Lindi në Shkup me datë 26 gusht 1910. Një ditë pas lindjes u pagëzua në kishën e Zembrës së Krishtit nga famullitari i atëhershëm Dom Zef Ramaj. Gonxhja ishte fëmija i tretë i Kolë Bojaxhiut me origjinë nga Rrethi i Shkodrës dhe e Drane Bojaxhiut (mbiemri i vajzërisë Barnaj) nga Novo Sella e Gjakovës.



Filloi puna për konstruksionin e rrugës ekzistuese të Dukagjinit 3

Fjala e dhanë po bëhet realitet! Me 24 gusht 2023, filuan punimet në aksin rrugorë Prekal-Kir. Falënderojmë bashkinë Shkodër dhe kryetarin e saj z. Benet Beci, për fillimin e punimeve në rrugën e Dukagjinit, në rrugën ekzistues Prekal-Kir-Mali i Shoshit-Kodër Shëngjergj-Breglumi e Nderlyasaj. Punë të mbare dhe realizim sa më të shpejtë të kërkesës dhe ëndrrës tone shumëvjeçare! Zoti e bekoftë Dukagjinin!

DY DUKAGJINAS "MIRËJOHJA E MALËSISË SË MADHE" 4

Me datën 11 gusht 2023, me propozim të Shoqatës kulturore e atdhetare "Malësia e Madhe", Kryetari i Bashkisë së Malësisë Madhe, zoti Tonin Marinaj, nderon me titullin "Mirënjohja e Malësisë së Madhe", këngëtari NIKË ÇARKU dhe poeti Lulash Brigja.

Kush është këngëtari Nikë Çarku? Nikë Çarku ka lindur në muajin korrik 1964, në fshatin Theth, kryeqyteti i Alpeve Shqiptare, në një familje me doke dukagjinase, me genin e folkut nga Gjyshi-Micani, nga Baba-Frani, nga axhat-Zefi, Gjergji, Deda e Prela dhe vëllezërit Luca e Martini dhe motra Gjystja, të cilët vijimisht kanë marre pjesë në grupet folklorike të fshatit, të krahinës së Shalës e zonës së Dukagjinit dhe deri në festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës, në veçanti të këngës "Maja krahut", duke i ra lahutës, çiftelies e fyellit ...

Nika u bë këngëtar me emër të veçante në gjitha trojet shqiptare.

Ai, që në moshën 9 -vjeçare ka dale në skenat e festivaleve. I ka kënduar trimave...

Shën Nënë Tereza - Nëna e Dashurisë, dritë për Botën

Shën Nënë Tereza lindi në Shkup më 26 gusht të vitit 1910 dhe kaloi në amshim më 5 Shtator 1997 në Kalkuta të Indisë. Njëpërmjet dashurisë për Krishtin dhe njeriun ajo arriti të pranohet nga njerëzimi si Nënë e Dashurisë, prandaj dhe u nderua me çmimin Nobel për Paqen. Me 19 Tetor 2003 nga Papa Gjon Pali i II Nënë Tereza shpallet e Lume. Me 5 shtator të 2016 nga Papa Françesku në Vatikan u shpall Shën Nënë Tereza

Lindi në Shkup me datë 26 gusht 1910. Një ditë pas lindjes u pagëzua në kishën e Zembrës së Krishtit nga famullitari i atëherëshëm Dom Zef Ramaj. Gonxhja ishte fëmija i tretë i Kolë Bojaxhiut me origjinë nga Rrethi i Shkodrës dhe e Drane Bojaxhiut (mbiemri i vajzërisë Barnaj) nga Novo Sella e Gjakovës. Kola dhe Drania patën 5 fëmijë, dy nga të cilët u vdiqën në fëmijërinë e hershme. Gonxhja kishte një vëlla dhe një motër. Vëllai quhej Lazër Bojaxhiu dhe studioi në Grac të Austrisë në Akademinë Ushtarake, por për shkaqe politike emigroi qysh herët në Itali, kurse motra quhej Age Bojaxhiu. Babai i saj merrej me tregti dhe mblidhte në shtëpinë e tij artistë dhe patriotë shqiptarë. Gonxhja mësimet e para i mori në një shkollë shqipe në Shkup, po atë e kreu dhe gjimnazin, por në gjuhën serbo-kroate. Pasionet e rinisë së Gonxhes ishin tre: të bëhej mësuese, të shkruante e recitonte poezi dhe të kompozonte e të luante muzikë. Nënë Tereza u largua më 26 shtator 1928 nga Shkupi në drejtim të Dublinit, Irlandë. Prej kësaj dite, nënë, bijë e motër nuk do të shiheshin më kurrë. Më 12 shtator 1928, Gonxhja kishte shkruar këtë letër drejtuar tezes së saj:

“Ky ishte momenti kur ajo u nda përfundimisht me familjen dhe vetëm pas 30 vitesh, do të takohej me vëllain, Lazarin. Kurse nëna Drania dhe motra Age, shkuan në atdhe, në Shqipëri, qysh para Luftës së Dytë Botërore. Nënë Tereza u vendos në Kalkuta (Indi) ku fillimisht u bë mësuese dhe shumë shpejt drejtore e shkollës së vajzave. “Nënë Tereza e Kalkutës” u quajt kur themeloi urdhrin “Misionaret e Dashurisë” (1951) për t’u shërbyer më të varfërve dhe më të pashpresëve të Kalkutës, Indisë dhe gjithë botës.

Në vitin 1979, kur mori Çmimin “Nobel” për Paqe, e gjithë bota mësoi se Nënë Tereza ishte shqiptare. Shkrimet e saj në shqip janë letrat e rinisë dhe më pas me familjen në shqip, përsëritet në shqip popullit shqiptar pas fitimit të çmimit “Nobel”, me 1979 dhe lutja në shqip transmetuar nga “Zëri i Amerikës”, me 17 qershor 1978. Në çastin e marrjes së Çmimit “Nobel”, më 1979, një nga klerikët që merrte pjesë në sallë e pyeti Nënë Terezën se nga ishte. Ajo deklaroi:

“Kam lindur në Shkup, jam shkolluar

në Londër, jetoj në Kalkutë dhe punoj për të gjithë njerëzit e varfër në Botë. Atdheu im është një vend i vogël me emrin Shqipëri”. Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë nuk i kishte dhënë vizë nobelistes së ardhshme as sa për të parë nënën e saj që jetonte në Tiranë, as për të marrë

që do ta bëjnë të jetojë përgjithmonë në zemrat e gjithë njerëzve, sidomos në zemrat e shqiptarëve.

Nënë Terezës, për të ardhur në Shqipëri iu desh të dërgonte tri letra. Ajo i kishte dërguar më parë letër Komitetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë, por nuk



pjesë në varrimin e saj më 1974, as për të parë varrin.

Shqiptarja trupvogël, por me zemër të madhe e drejtuar nga provania e Zotit ishte nënë kujdestare e 7 500 fëmijëve në 60 shkolla, ishte nënë që mjekonte 960 000 të sëmurë në 213 dispanser, ishte e vetmja në botë, që trajtonte 47 000 viktimat të lebrozës në 54 klinika, kujdesej për 3 400 pleq të braktisur e të lënë rrugëve, në 20 shtëpi pleqsh, kishte bërësuar 160 fëmijë ilegjitimë e bonjakë. Këto janë shifrat e mesit të viteve '80. Deri sa Nënë Tereza ishte gjallë dhe sot e kësaj dite shifrat kanë ndryshuar shumë.

Nënë Tereza nuk qe ndonjë perëndeshë dhe me të mund të fliste çdonjëri. Madje ajo kishte edhe adresë të saktë: një godinë ngjyër hiri në Bose Road, të ndërtuar në një lagje të zhurmshme dhe çjerrëse, të stërmbushur me njerëz, e cila vlonte nga çajbërësit, shitësit dhe tregtarë të tjerë të pjesëve më të ndryshme këmbëse si dhe lëngështrydhësit. Këtu, mu në qendër të Kalkutës shtrihej shtabi i përgjithshëm i Rregullit, “Shtëpia e Nënës”, pranë portës të së cilës qe vendosur një tabelë druri ku shkruante: “Mother Teresa. IN/OUT”. Shtëpinë e Nënë Terezës e kanë vizituar personalitete si mbretëresha e Britanisë, ish presidentët e Shteteve të Bashkuara George Bush e Jimmy Carter, Yasser Arafati, princesha Diana e shumë të tjerë. Nënë Tereza ka qenë mjaft bujare, humane e zemërgjerë dhe këto janë karakteristikat

mori kurrë përgjigje. Ja se si e shpjegon Lolja letrën e të madhes Nënë Terezë dërguar: Nënë Tereza tha “Me gjak, unë jam Shqiptare. Me shtetësi, jam Indiane. Me besim, unë jam një murgeshë Katolike. Sipas profesionit tim, unë i përkas botës. Për nga zemra ime, unë i përkas plotësisht Zembrës së Jezusit.”

Në 1982, në kulmin e Rrethimit të Beirutit, Nënë Tereza shpëtoi 37 fëmijë të bllokuar në një spital ushtarak duke ndërmjetësuar një armëpushim të përkohshëm ndërmjet ushtrisë Izraelite dhe guerilëve palestinez. E shoqëruar nga punëtorët e Kryqit të Kuq, ajo udhëtoi përmes zonës së luftës deri tek spitali i shkatërruar për të zhvendosur pacientët e rinj.

Kur Evropa Lindore pati një rritje në sinqeritet në fund të viteve 1980, ajo i zgjeroi përpjekjet e saj në vendet komuniste që më parë kanë refuzuar Misionarët e Bamirësisë, duke u përfshirë në shumë projekte. Ajo nuk u tremb nga kritikët për qëndrimin e saj kundër abortit dhe divorcit duke thënë, “Pavarësisht kush thotë çfarë, ti duhet ta pranosh atë me një buzëqeshje dhe të bësh punën tënde”. Ajo vizitoi Republikën Sovjetikë të Armenisë pas tërmetit të vitit 1988, dhe u takua me Nikolai Ryzhkov, Kryetari i Këshillit të Ministrave.

Nënë Tereza udhëtoi për të ndihmuar dhe shërbyer të uriturve në Etiopi, viktimave të rrezatimit në Cernobill, dhe viktimave të tërmetit në Armeni. Në 1991,

Nënë Tereza kthehet për here të parë në vendlindjen e saj dhe hapi shtëpinë e Vëllezërve Misionarë të Bamirësisë në Tiranë, Shqipëri. Deri më 1996, Nënë Tereza ishte duke punuar në 517 misione në më shumë se 100 vende. Gjatë viteve, Bamirësia e Misionareve të Nënë Terezës u zgjerua nga dymbëdhjetë në mijëra persona që u shërbejnë “me të varfërve nga të varfrit” në 450 qendra në mbarë botën. Shtëpia e parë e Misionarë të Bamirësisë në Shtetet e Bashkuara ishte themeluar në Bronksin e Jugut, Nju Jork; deri më 1984 asambleja punonte në 19 institucione gjatë gjithë vendit. Nënë Tereza fliste rrjedhshëm 5 gjuhë: Bengalisht, Shqip, Serbisht, Anglisht dhe Hindishte.

Në 13 Mars 1997, ajo la pozitën e kryetares së Misionarëve të Bamirësisë. Ajo ndërroi jetë me 5 Shtator 1997.

Në kohën e kohë, Misionarët e Bamirësisë së Nënë Terezës pati mbi 4 000 motra, dhe një vëllazëri prej 300 anëtarësh, duke punuar në 610 misione në 123 vende. Këto përfshinin bujtina dhe shtëpi për njerëzit me HIV/AIDS, me lebrose dhe tuberkulozë, kuzhina supe, programe këshillimi për fëmijë dhe familje, ndihmë personale, jetimore dhe shkolle. Misionaret e Bamirësisë u ndihmua edhe nga bashkëpunëtorët, të cilët ishin mbi 1 milion deri me 1990.

Shën Nënë Tereza u prehe në Shën Tomas, Kalkutë për një javë para funeralit të saj, në Shtator 1997. Asaj iu dha funeral shtetëror nga qeveria Indiane në shenjë falënderimi për shërbimin e saj për të varfrit e të gjitha feve në Indi.

Shën Nënë Tereza u bë një nga urat ndërlidhëse të njohjes së shqiptarëve në botë. Bill Clinton është shprehur në qershor 2002: “Nënë Tereza, ishte e para Ajo, që më bëri ta dua kombin shqiptar. Dhe tani ndihem shumë krenare, që plotësova një detyrë morale ndaj saj dhe ndaj vlerave të lirisë”. Por origjina shqiptare nuk duhet absolutizuar. Duke qenë shqiptare ajo nuk i përket vetëm Shqipërisë. Gonxhja u bë qytetarja e botës, e popujve, feve dhe e qytetërimeve. Ndër titujt që i janë dhënë përmendim: Pamada Shir; Gjoni XXIII për Paqe, të cilën ia dorëzoi personalisht Papa Pali VI; Samaritani i Mirë, në Boston; Shpërblimi Ndërkombëtar John Kennedy, në Uashington; Nëna e të Gjitha Nënave, Balzan; Çmimi Nobel për Paqe; Medalja e Lirisë, shpërblimi më i lartë amerikan; Medalja e Paqes, shpërblimi më i lartë i Rusisë; e të tjera.

Këshilli i Ministrave miratoi një ndryshim në ligjin “Për festat zyrtare” në vend, sipas të cilit data 19 shtator që është Dita e Lumturimit të Nënë Terezës, zëvendësohet me datën 5 shtator, që është Dita e Shenjtërit të saj.

Pesë shtatori i 2016-s shënoi në kalendarin Apostol Ditën e Shenjtores shqiptare, Nënë Tereza e Kalkutës.

Roza Pjetri

NJOFTIM: Filloi puna për konstruksionin e rrugës ekzistuese të Dukagjinit

Fjala e dhanë po bëhet realitet!
Me 24 gusht 2023, filuan punimet ne aksin rrugore Prekal-Kir.

Falënderojmë bashkinë Shkodër dhe kryetarin e saj z. Benet Beci, për fillimin e punimeve në rrugën e Dukagjinit, në rrugën ekzistues Prekal-Kir-Mali i Shoshit-Kodër Shëngjergj-Breglumi e Nderlytaj.

Punë të mbare dhe realizim sa më të shpejte të kërkesës dhe ëndrrës tone shumëvjeçare!

Zoti e bekoftë Dukagjinin!

Disa opinione të shkurtra:

Lazer Kodra: Përshëndes fillimin e punimeve. Por dua të kujtoj thënien e një filozofi grek, që thoshte: "Unë nuk them se jam i lumtur pa e parë fundin!"

Tonin Mani: Ëndrra shumëvjeçare me ndihmë të Zotit do bahet realitet për zonën e Dukagjinit, brenda pak viteve Alpet Shqiptare do të kenë 1 me 1.5 milion Turistë në vit. Tani, nëse duam Turistet të rrinë në zonën e Dukagjinit, ose të jene kalimtar, kjo ashte në dorën tone, duhen investime në të tre Njësite Administrative Pult, Shosh e Shale, se e kemi një Bujtinë, një Restorante...!!!

Mirsad Basha: I lumtë z. Benet Becit për ato shume takime me grupin organizativ bashke me ekspertet, jo veç që bani

dëgjesa, por dhe mbas 2 muajve filloi punën. Ma në fund një drejtues mendoi për këtë rrugë, që do jete porta ma kryesore e zhvillimit ekonomik të qytetit tone.

Agostin Gjini: Shpresojmë, donë zoti e ëndrra e zonës së Dukagjinit realizohet,



e mbajtën karrigen në Bashki dhe asnjë fond nuk munden me mbledh minimum me mirëmbajete këtë rrugë.

Vata Demaj: Dukagjin o Vend Zotit Krenaria e këtij Kombi, duke parë fillimet e punimeve në rrugën e Dukagjinit më



traditat tona: Besën, Burrnin dhe zemrën e Pastërti ashtu si uji i burimit që rrjedhë nga trojet e të pareve tone.

Lulash Brigja: Suksesë ëndrrës sonë për një rrugë që e meritojmë. Nuk jemi ba më të mirë se ishim deri sot! Çdo fillim i vonuar të gazon shumë, por çdo lule që çel në gusht e zë bora lulen. Një gjë dihet: Fjala (protesta) jone u dëgjua dhe Kryetari e mbajti fjalën. Rruga do kohë me mbaru. Suksesë!

por mua po me vjen keq për "dy gishtat", a munden me e pa këtë investim, sepse ata tash 30 vjet s' kane ba as gja për këtë trevë,

Alfons Kopshti: Të lumtë i pari Krye bashkiak për bashkësinë e DUKAGJINIT! Presa i përket kryebashkiakve të mëparshëm kanë qen vetëm mospërfillës ndaj kësaj bashkësie, që i ka dhanë shumë SHKODRËS e tanë Shqipërisë dhe 32 vjet

erdhi shumë mirë dhe u gëzova pa masë, prandaj përshëndes me gjithë zemër Kryetarin e Bashkisë Shkodër z. Benet Becin për fillimin e punimeve për këtë rrugë jetike për popullin e Dukagjinit, i cili do mbetet një nga njerëzit më të dashur dhe ma human për popullin e Dukagjinit/. I bëj thirrje çdo dukagjinase që të jemi të bashkuar si asnjë herë tjetër, të ruajmë

Vatë Mali: Une jam shumë dakord, që rruga ka fillua dhe në çfarë do lloj mënyre që ka fillua do të përfundoje, por meqenëse nuk ka një datë mbarimi kam një pyetje për zotin Benet Becin: A do e përfundoni këtë rrugë me gjeth parametrat deri në vitin 2025?

Redaksia

Shoqata e Pyjeve e Kullotave Barcollë-Shllak humb drejtuesin e saj Nikë Dedë Preka

Me gjithë shërbimin shëndetësor intensiv prej ditësh në spitalin e Shkodrës, nuk ka mundur të shpëtoj nga një aksident rruqor duke i marrë jetën Nikë Dedë Prekës. Lindi me 2 gusht 1949, i biri i të ndjerëve Dedës e Zades, vëllai i Ndocit, Zefit, Hilës, Maries, Gjergjit dhe Gjoloshit. Vinte nga një familje e nderuar e fshatit Barcollë, të krahinës së Shllakut.

Nika u bë shumë i njohur në qendër të Shllakut në Log të Gegajve, ku filloi punë

si banakier në klubin dhe restorantin që ishte i NTSH-2, ishte i vetmi në të gjithë zonën. Edhe pse çdo ditë udhëtonte mbi dy orë në këmbë, ai ishte një shërbyes i komunikueshëm me të gjithë.

Banaku ishte vendi ku takoheshin udhëtarët, kuadrat e kohës, shume raste ndihmonte mjaftë banorë në zgjidhjen e problemeve të kohës.

Nika do të mbetet në kujtesën, që u angazhua me plotë energji në krijimin e

Shoqatës së Pyjeve e Kullotave Barcolles në krahinën e Shllakut.

Nga kjo shoqatë mbetet vlerësimi maksimal për punën këmbëngulëse në ruajtjen e sipërfaqeve pyjore e kullotave të krahinës së Shllakut, në identifikimin, inventarizimin dhe kalimin në pyje private.

Me njohjet miqësore që kishte dhe familjen punonte fort në mbrojtjen e diversitetit dhe të pasurive natyrore të trevës tonë. Fal investoreve të huja punoj për pastrimin e pyjeve, luftën ndaj sëmundjeve si dhe në ndërtimin e lerave ujëmbajtëse e prita malore.

Nika do të mbetet një njeri i dashur dhe i paharruar për të gjithë krahinën e Shllakut.

Shprehim ngushëllime bashkëshortes



Prendës, djemve dhe të gjithë të afërmeve për vdekjen e parakohshme të Nikës!

Pushofsh në paqe Nikë Deda!

Ndoc Prendushi, Zef Nika

Sot Dita Botërore e Shalqirit, historia e frutit të ëmbël që daton prej Egjiptit të Lashtë

Dita Botërore e Shalqirit festohet më 3 gusht dhe në këtë ditë njerëzit në mbarë botën festojnë frutin e shijshëm dhe freskues i cili daton që nga Egjipti i Lashtë.

Kultivimi i këtij fruti daton në vitin 2000 para Krishtit, me vjeljen e parë të shalqirit të regjistruar rreth 5000 vjet më parë në Egjipt. Gjurmët e shalqirit dhe farave të tij janë zbuluar në vendet e dinastisë së 12-të egjiptiane, duke përfshirë edhe varrin e mbretit Tutankhamen. Në mbishkrimet e lashta egjiptiane janë gjetur edhe piktura të llojeve të ndryshme të shalqirit.

Fruti i ëmbël është rezultat i mutacione-

ve gjatë një mijë vjetësh kultivimi. Farat e shalqirit u shiteshin tregtarëve që kalonin nëpër rrugët tregtare në shkretëtirën Kalahari në Afrikë. Nga atje, kultivimi i shalqirit u përhap në të gjithë Afrikën. Origjina e paraardhësit të shalqirit ishte në Afrikë, pas së cilës u përhap në vendet e Mesdheut dhe pjesë të tjera të Evropës. Nga fundi i shekullit të nëntë, kultivimi i shalqirit u bë i zakonshëm në Kinë dhe në pjesën tjetër të Azisë.

Sipas "Dictionary of American Food and Drink" nga John Mariani, fjala 'shalqi' u shfaq për herë të parë në fjalorin anglez në vitin 1615. Shalqiri zakonisht njihet si

një lloj pjepri, por nuk është në gjininë "Cucumis".

Në Ditën Kombëtare të Shalqinit, njerëzit në mbarë botën kënaqen me shumëllojshmërinë e mrekullueshme të shalqinjve, duke shijuar ëmbëlsinë dhe shijen e tyre të lëngshme. Dita Kombëtare e Shalqirit nuk është thjesht një festë e një fruti të shijshëm, por edhe një mundësi që njerëzit të mblidhen së bashku, të ndajnë njohuritë dhe të kënaqen me gëzimin e shijimit të bujarisë së natyrës. Çdo pjesë e shalqirit është e ngrënshme, duke përfshirë edhe lëkurën e hedhur shpesh, e cila ka shumë lëndë ushqyese.

Me përmbajtjen e tij

mbresëlënëse prej 92% ujë, shalqiri ju mban të hidratuar. Ka më shumë se 1200 lloje të ndryshme shalqiri, duke ofruar një ylber ngjyrash dhe shijesh, nga roza dhe e kuqja tradicionale deri te varietetet ekzotike të verdha dhe ngjyrë akulli.



DY DUKAGJINAS “MIRËJOHJA E MALËSISË SË MADHE”

Me datën 11 gusht 2023, me propozim të Shoqatës kulturore e atdhetare “Malësia e Madhe”, Kryetari i Bashkisë së Malësisë Madhe, zoti Tonin Marinaj, nderon me titullin “Mirënjohja e Malësisë së Madhe”, këngëtari Nikë Çarku dhe poeti Lulash Brigja.

Kush është këngëtari Nikë Çarku?

Nikë Çarku ka lindur në muajin korrik 1964, në fshatin Theth, kryeqyteti i Alpeve Shqiptare, në një familje me doke dukagjinase, me genin e folkut nga Gjyshi-Micani, nga Baba-Frani, nga axhat-Zefi, Gjergji, Deda e Prela dhe vëllezërit Luca e Martini dhe motra Gjystja, të cilët vijimisht kanë marre pjese në grupet folklorike të fshatit, të krahinës së Shalës e zonës së Dukagjinit dhe deri në festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës, në veçanti të këngës “Maja krahut”, duke i ralahutës, çiftelies e fyellit ...

Nika u bë këngëtar me emër të veçante në gjitha trojet shqiptare.

Ai, që në moshën 9 –vjeçare ka dale në skenat e festivaleve. I ka kënduar trimave të maleve, Dukagjinit që e lindi, këndoi në dasma, kolegeve e kolosëve të folkut shqiptar, si Mhill Çunit, Sali Manit e Kosovës, Bjeshkëve të Rugovës, Bijve të shqipeve e të tjera, në kullat e sallat e Nju-Jorkut...

Nika ka mbaruar shkollën e larte për inxhinier mekanik dhe punon në profesionin e tij, krahas marrjes në vijimësi me art, kryesisht këngën; mbi 25 vite mësues për frigoriferët ...

Këngëtari Nikë Fran Çarku, në kuadrin e 100 vjetorit të arsimit në Dukagjin, Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” e ka nderuar me titullin “100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin”.

Nike Çarku urime e urime, vijoni e vijoni në shërbim të folkut shqiptar, në veçanti në trevat e veriut me faqe të bardhe si dhe deri më sot!

Kush është poeti Lulash Brigja?

Lulash Brigja, lindur me 21 janar 1968, në fshatin Kir, Njësia Administrative Pult. Është familjarë, i martuar, ka dy fëmijë.

Lulashi mbaroj Shkollën 8 vjeçare në fshatin Kir për të vijuar përgjatë viteve 1984-1988 të mesmen e përgjithshme “Mehmet Shpendi”, në Breg-Lumi

Studimet e larta i kreu në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër, në vitet 2006-2010, në degën Bio-Kimi.

Fillimet e punës së tij Lulashi i ka në detyrën e mësuesit të lëndës Bio-Kimi në Shkollën 8-9 vjeçare të Kirit dhe në administratën e Kooperativës Bujqësore të asaj kohë.

Vitet 90-të si çdo të ri e gjeti shumë aktiv e të përfshirë në lëvizjet demokratike të kohës, por duke e parë se politika nuk ishte fusha e Tij e preferuar, emigroj për disa vite në Greqi, për tu rikthyer e punuar në profesione të lira, aty ku Lulashi gjente veten, por pa u ndare asnjëherë nga libri, arti e kultura, në të cilat e gjente veten më së miri.



Këngëtari Nikë Çarku e poeti Lulash Brigja, në ditën e marrjes së titullit “Mirënjohja e Malësisë së Madhe”



Kryetari i Bashkisë së Malësisë së Madhe, Tonin Marinaj dhe Nike Çarku



Lulashi, me vajzën-Lindita e kryetarin e Bashkisë së Malësisë së Madhe, z. Tonin Marinaj

Me gjallërimin e mediave të shkruara dhe vizive në gjithë Qarkun e Shkodrës, punoj gazetar e bashkëpunëtor me disa media lokale në Shkodër dhe në Malësi të Madhe, duke dhënë kontributin e tij, e duke u bërë një penë e dallueshme në ketë fushë.

Për disa vite punoj dhe në detyrën e punonjësit të kulture në Shoqatën Artistike “Treva”, me qendër në Shkodër. Aftësitë e Tij organizative dhe letrare i dhanë një tjetër dimension veprimtarive kulturore në Malësinë e Madhe falë punës tashmë me muzikën folklorike dhe trashëgiminë kulturore të Trevës së Dukagjini.

Lulashi ka punuar dhe ne detyrën e inspektorit të kulturës ne komunat Pult dhe Rrethina Shkodër.

Prej shumë vitesh është anëtar i Unionit të Gazetareve, dega Shkodër dhe anëtar i redaksisë së gazetës “Dukagjini”

Lulashi, që nga viti 2016 e në vijim punon te Qendra Aftësimit Formativ Selezian (QAFS...), Shkollë private, duke qenë kështu i aktivizuar në disa fusha, por që me vullnet, pasion e profesionalizëm ka ditur të ruaje balancat e të gjithave e t’ia dalë të jetë një artist e profesionist i kompletuar.

Komunikon mirë në gjuhën Italisht dhe Greqisht.

Lulashi tashme ne fushën e Publicistikes dhe Poezisë mban autorësinë e dhjetëra artikujve në gazetën “Dukagjini” në gazetën “Shqipëria Etnike” dhe disa gazeta të tjera të formatit online

Ka botuar dy vëllime me poezi të tituluara “KUR PUTH DIELLI”, në vitin 2010 dhe “YLBER ME VARGJE”, në vitin 2017

Në vargjet e Lulashit vijnë aq bukur temat e dashurisë djaloshare, gërshtuar me bukuritë e paskajshme të vendit ku ai u rrit veshur aq bukur me metafora, që vetëm një njeri me shpirt artisti mund ti përcjelle.

Mjafton të kapë çastin e ta zërtheje në një krijim, që here të ngjan me një pikturë, here me një film me metrazh të shkurtër, dhe here si përjetim shpirti, mbushur me emocion.

Firmën e Lulashit sot mbajnë dhe mbi 150 tekste këngësh folklorike dhe popullore, që janë të kënduara e të regjistruara në kanal në youtube, dhe tashme kanë autorësinë e tij.

Fotografia është një tjetër pasion dhe profesion i tij, dhe pas kësaj nuk mbetet tjetër veçse ta quajmë Lulashin artistin

shumë dimensional që fusha e se bukurës, Artit, Kulturës e Arsimit kanë gjetur aq bukur se si të ndërthuren për t’iu veshur si kostum, e për ta bere Lulashin një vlerë e çmuar për gjithë bashkësinë.

Për disa vitesh ishte drejtues letrar dhe drejtues artistik në shoqatën “TREVA” dhe tani ketë veprimtari e ushtron tek “Sofra e Dukagjinit”.

Nuk mungon opinionin e tij në promovime librash e veprimtari të ndryshme letrare. Gjithashtu ka qene dhe pjese e veprimtarive e konkurseve letrare duke u vlerësuar shpesh dhe me çmime.

Për gjithë kontributin e tij të lartpërmendur Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” e ka nderuar me titullin “100 vjet Arsim e Kulturë në Dukagjin”, dhe për kontributin në redaksinë e gazetës e ka nderuar me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”, në kuadrin e 20 vjetorit e daljes së numrit të pare të gazetës “Dukagjini”.

Urime dhe me faqe të bardhë në vijimësi poeti Lulash Brigja!

Ndue Sanaj



Këngëtari Nikë Çarku me të motrën Gjyste Bici-Çarku



Lulashi në mes djalit-Pavlini dhe vajzës-Lindita

DITA E PLISIT NË JUNIK

Në Oda Pleqnare e Junikut u mbajt edicioni i 10- te i Manifestimi "Dita e Plisit", organizuar nga: Komuna e Junikut, Oda Pleqnare e Junikut, në bashkëpunim me Lidhja e Krijuesve Shqiptarë në Mërgatë, Shoqata Mbarëkombëtare "Plis Bardhë" dhe Shoqata "Dardania" Mannheim. Shoqata Atdhetare Dukagjini Shkodër si gjithmonë ishte e ftuar dhe mori pjesë me kryetarin e saj, z. Ndue Sanaj, z. Gjon Vojvoda, z. Gjon Kosteri dhe Lulash Brigja.

Mesazhi dhe ideja e veprimtarisë ishte:

- Ruajtja e trashëgimisë kulturore artistike të Kombit tone,

- Bashkërendimi i punës për të dorëzuar në UNESKO dosjen për Plisin e Bardhë,

- Vazhdimi i takimeve midis Shoqatave kulturore dhe artistëve nga mbare Trojet Shqiptarë,

- Promovimi i Odes Pleqnare të Junikut dhe historikut te saj.

Ishte një takim jubilar ku fjalën e hapjes të letrar e kulturor e mbajti Kryetari i Komunës z. Ruzhdi Shehu.

Morën pjesë shumë shoqata dhe artiste nga mbare Trojet Shqiptarë dhe Diaspora në këtë takim.

Shoqata Atdhetare "Dukagjini" si gjithmonë u përfaqësua me dinjitet, falë përvojës shumë vjeçare të bashkëpunimit me Organizatoret e Ditës të Plisit. artistin z. Ismet Krasniqi-Lala dhe grupin e tij.

Ne, përveç pjesëmarrës në elementët e programit, nderuam me vlerësime dhe mirënjohje disa personalitet të artit dhe kulturës në Kosovë.

Me numër vendimi të Kryesisë së Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", 276, date 6 / 07 / 2023, u dha titulli:

A Me titullin "Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini":

1. Ismet Krasniqi-Lala, nga Klina, aktor e krijues, Kryetari i grupit organizator i veprimtarive mbi "Ditës se Plisit", me motivacion: "Për kontributin e çmuar krijues dhe organizativ, hulumtim e promovim të vlerave tradicionale kulturore të kombit shqiptar; për kontributin tuaj në bashkëpunimit shumë vjeçar në veprimtari të përbashkëta atdhetare, kulturore e artistike në realizimin e misionit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjinit"

2. Fahri Xharra, historian nga Gjakova, me motivacion: "Për kontributin publicistikë e studimorë historike në shërbim të mbrojtjes së identitetit tonë kombëtar, ju bëjnë të njohur dhe të vlerësuar kudo në trojet tona Shqiptare; poet, publicist dhe historian e vlerësojnë dhe e mbështesin kauzën tuaj historiko-shkencore"

B Me titullin "Mirënjohja Martin Camaj":

1. Migena Arllati, poete e veprimtare, nga Gjakova, me motivacion: "Për kontributin në fushën e kulturës dhe letërsisë Shqipe, poete e studiuese me vlera të larta kombëtare, dhe me një kontribut të shquar në realizimin e misionit të veprimtarive "Dita e Plisit"

2. Agim Desku, poet e veprimtare, nga Peja, me motivacion: "Për kontributin në fushën e kulturës dhe letërsisë Shqipe, poet me vlera të larta kombëtare dhe



me kontribut të shquar në realizimin e misionit të veprimtarive "Dita e Plisit"

C Me titullin "Mirënjohja ec Shoqatës Atdhetare Dukagjini":

1. Oda pleqnare e Junikut, me motivacion: "Odë me traditë për burri, për vendimmarrje me rëndësi për kombin

shqiptar në periudhat e ndryshme historike, odë e rezistencës kundër sunduesve, e tani odë mikpritëse e Plis-Bardhëve"

2. Lidhja e Krijuesve Shqiptarë në Mërgatë, me motivacion: "Për ruajtjen dhe kultivimin e kulturës dhe trashëgimisë

në vendet ku jetojnë e veprojnë, ruajtja dhe kultivimi i lidhjeve të rregullta me Atdheun përmes vizitave, promovimit të librave dhe tani Plisi na bashkon me veprimtari të përbashkët, mërgatë-Atdhe"

3. Zeqir Mehmetaj, TV "FONTANA", ne Peje, me motivacion: "Për kontributin shumë vjeçar në promovimin e vlerave kulturore, historike kombëtare; për punën në informim dhe miqësisë midis vëllezërve Shqiptare kudo që ndodhen dhe një zë i fuqishëm për promovimin e veprimtarisë së Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe të Plisit të Bardhë"

Veprimtaria vijoje me Orën Letrare "JUNIKU, Oda, fjala, vargu", lexime poezi dhe pika artistike e kulturore,

- Me nderimin e disa personalitetëve të mirënjohura dhe të shquara atdhetare, krijuese e kulturore Shqiptare, pastaj një drekë tradicionale brenda Kompleksit "Oda Pleqnare e Junikut",

- Një vizite para Memorialit të Heroit të Kombit Edmond Hoxha,

Ishte një dite gushti e nxehte dhe e bukur, që për ne do mbetet gjate në kujtesë, por edhe do i shërbej qëllimita për të cilën u mbajt.

Unë po përcjell një kolazh me foto pikante që do të mbeten si dëshmi e një veprimtarie kulturore e artistike të suksesshëm.

Faleminderit miqtë e mi që kaluam një dite të bukur, tu rrit ndera Gjon Vojvoda!

Përsëritet dhe respekt për të gjithë pjesëmarrësit miqtë e mi artiste, krijues dhe poet në Kosovë dhe mbar Trojet Shqiptarë.

Për përgatitjen e pjesëmarrjen në këtë veprimtari, kontribuuan të gjithë, Gjon Kosteri, Gjon Vojvoda, Lulash Brigja, por në mënyrë të veçantë kontribuuan Nikë Gjellaj e Pal Lera! Te dy falënderojmë me shprehjen popullore "Paçin e dhënçin!"

Opinion:

Frashër: Plisi quhet mbulesa e bardhë prej leshi, të cilën pellazgët, Ilirët e më vonë shqiptarët e përdorën për ta mbuluar kokën. Quhet plis, sepse është e krijuar prej leshit të deles së bardhë (kujto fisi ilir i delmatëve ose dalmatëve dhe Dalmacia). Pra prej leshi, në dialektin gegë bënë pi-leshi ndërsa në gjuhën e vjetër bënë pi-lesi prej nga rrjedh pi-lisi dhe p'lisi e ku pastaj shkurtimisht e përfundimisht quhet plisi. Qeleshja apo Plisi është simbol dhe mbulesë tradicionale e kokës ndër shqiptarët. Plisi është një kapele, që shpeshherë cilësohet si më e veçanta, pasi ajo përdoret vetëm në trojet shqiptare. Zakonisht plisi mbahet si pjesë e kompletit të rrobave folklorike apo ashtu i vetëm në ceremonitë e ndryshme shoqërore. Në disa pjesë rurale në veri të tokave shqiptarë mbahet edhe si mbulesë e kokës e kombinuar edhe me rroba të kohës. Kohëve të fundit plisi po përdoret vetëm i bashkangjitur me veshjet kombëtare, të cilat përdoren vetëm për festat kombëtare e historike të popullit shqiptar, e jo si një kapele që zë vend në gardërobën e përditshme.

Lulash Brigja

* Junik, 1 gusht 2023

NJË DEKADË ME PLISIN

- Rrugëtimi dhjetëvjeçar i manifestimit “DITA E PLISIT”, në Kosovë 2014-2023

Tashmë Dita e Plisit ka krijuar një traditë prej një dekade të plotë. Qëllimi kryesor ka qenë që të kujtohen e kultivohen traditat shqiptare, ato shenja etnike që e dallojnë kombin tonë dhe që na mbajnë gjallë, siç janë flamuri, kulla, plisi, kënga folklorike, anekdotat, kumtesat, ushqimet tradicionale.

Ismet Krasniqi është ideator e organizator i manifestimit nga trashëgimia kulturore “Dita e Plisit”.

1. Plisi sot

Ndër mileniume e shekuj shqiptari iliro-arbëror, është dalluar me veshjen e tij kombëtare, me gjuhën, me flamurin dhe, gjithsesi, me PLISIN. “Shqiptari tregohet me shej, kur e ka plisin”, thoshin pleqtë dikur. Prandaj, gjithmonë plisi është konsideruar dhe konsiderohet shenjë e autoktonisë etnike shqiptare. Kjo shenjë e identitetit shqiptar, ka rrënjë të moçme, mu si lashtësia e qenies së tij në gjuhë, trashëgimi e kulturë. Plisi shënjonte krenarinë e shqiptarit, kudo e kurdo që gjendej jashtë shtepisë së tij. Plisi ka ngjyrën e bardhë. Bardhësia e tij (dhe e veshjes shqiptare), nuk thjesht vetëm ngjyra e ambientit (dimëror), ku ka jetuar malësori. Por kjo bardhësi ka vlerë simbolike të shumëfishtë: është ngjyrë e pastërtisë, e pastërtisë etike të qenies kombëtare. Ngjyra e bardhë është simbol i pastërtisë, dritës, prosperitetit... është arketip shqiptar i IDENTITETIT, Vetënjohjes, që nga mitet antike e kozmogonike e deri në thellësinë e kohëve historike... Shqiptarin ndryshe as nuk mund ta përfytyrojmë, përpos me PLISIN në krye; qeleshebardhë 8 ishin luftëtarët shqiptarë që nga kohët e mugëta ilirike e deri në kohët moderne. Plisi ka lashtësinë e kësaj bardhësie, që e takojmë SI DËSHMI, në skulptura antike dhe mite (Odisenë, perënditë greke e iliro-pelazge), e takojmë tek krerët e lartë fetarë të krishterimit, tek papët. Papa Klementi Albani, që ishte shqiptar, kudo paraqitet me plisin e bardhë. Kjo bardhësi ndërlihet me aureolat e shenjta qofshin ato të riteve pagane, ato të besimeve monoteiste. Plisi ishte aty, me shenjtërinë e tij...

Pjesë e pandashme e qenies së tij dje, PLISI SOT tashmë është shndërruar në RELIKT të së kaluarës trashëgimore, në shenjë të ceremonialit folklorik, në manifestime kulturore që e tregojnë këtë vlerë folklori (në ekzekutimin e këngëve dhe valleve)...dhe ende ruhet si ritual gëzimësh e dasmash. Me depërtimin e formave moderne të jetesës, tashmë plisi nuk mbahet, pos te pleqtë e rrallë e të moshuar, që sillen dhe jetojnë sipas dokeve të traditës.

Ndërkaq, ndaj plisit, sillen me respekt të gjithë. E nderojnë si relikte të shenjtë, edhe të rinjtë. E mbajnë në raste solemnitetesh a gëzimësh. Gëzimi është më i plotë, autokton, po të mbahet ai. Përpos kujtesës folklorike, plisi është motiv i përhershëm frymëzimi edhe tek shkrimtarët tanë. Që nga shkrimtarët e Rilindjes e deri më sot, janë shumë poetë që plisin e marrin si figurë të pandashme nga fatet



Nga e majta në të djathtë: Poeti e skulptori Gjon Gjergjani, aktori e botuesi Ismet Krasniqi-Lala, shkrimtari-poeti e studiuesi Prend Buzhala dhe piktori e poeti Idriz Bersha-Xhixhi



Pjesëmarrës në veprimtarinë “Dita e Plisit të Bardhë”



Ndue Sanaj, Kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, duke përshëndetur në “Diten e Plisit”, në Prekaz

e shqiptarit. Për plisin ka motive poetike nga shkrimtarët si Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Azem Shkreli, Ali Podrimja, Basri Çapriqi, Fatos Arapi e të tjerë, ndërkaq, në prozë, sidomos në romanet me tematikë

historike e shoqërore, përshkrimet e personazheve me plis janë ndër më të frymëzuarat. Mjaft tituj veprash në prozë e në poezi, ndërthejnë këtë fjalë. Ka dhe mjaft poetë të kohëve të sotme që kanë shkruar

vargje për plisin e që janë përfshi te vëllimet “Dita e plisit”, së bashku e këngët popullore që i kushtohen atij.

2. Vendet e kullat ku u mbajt manifestimi DITA E PLISIT

Deri më tash, manifestimet janë mbajtur nëpër ambiente tradicionale etnike e sidomos nëpër KULLAT MEMORIALE, anembanë Kosovës, që kanë rëndësi historike, që lidhen me kujtesën e një ngjarjeje historike, kombëtare, kulla-muze që kultivojnë dhe ruajnë e mirëmbajnë eksponate nga tradita jonë, nga arkeologjia, veshjet tradicionale apo nga ato të qëndresës shqiptare.

Kështu, për një dhjetëvjeçare rresht, këto manifestime janë mbajtur deri më tash në Krushevë të Vogël, në Kullën Muze të Gjon Nikë Gjergjaj (edicioni i parë 2014); në Kullën e Zenel Berishës në Dobërdol të Klinës (edicioni i dytë 2015); në kullën e Vehbi Ukë Isufajit- Qendra Rajonale e Turizmit në Junik (edicioni i tretë 2016); më 2017 në kullën e Azem Galicës në Galicë - komuna e Vushtrrisë; më 2018 në kullën e Daut Feratajt në fshatin Uçë- Podgur (komuna e Istogut); në Kullën Muze të Zahir Pajazitit në Orllan të Llapit; pastaj në Kullën muze të Isa Boletinit- Boletin-Mitrovicë, më 2019 (në tri pjesë) në ambientet e trashëgimisë etnike Zym të Hasit; pastaj në Jezercë të Ferizajt e në Prekaz në Kullën muze të Ahmet Delisë; në vitin 2020 u mbajt te “Ujëvara e Mirushës” në rrethana më të kufizuara për shkak të Covidit 19; më 2021 manifestimi “Dita e Plisit” u mbajt në Stankaj të Rugovës dhe në fshatin Prugovc të Prishtinës; më 2022 edicioni IX, u zhvillua në bashkëpunim me shumë shoqata si me Festën Dita e Plisit të Bardhë, që mbahet në Dajt të Tiranës dhe që e udhëheq Agron Isa Gjedia. Ndërkaq, manifestimi kryesor u mbajt në Poliçkë të Dardanës, në Kullën memorialë të Kadri Zekës. Sivjet u shënuar dhjetëvjetori. Fillimisht, u mbajt në fshatin Debelldeh, në ambientet me pamje të traditës, të mërgimtarit Sali AVDULLAHU, vijoi sivjet me moton: “TË GJITHË ME PLISA - PLISI SHQIPTAR NË UNESKO” dhe u kurorëzua në Kullën Muze ODA E JUNIKUT, në Junik, në bashkëpunim me shoqatat tjera, si LSHSHM (mërgatë) e të tjera, me moton “Plisi në UNESCO”.

3. Veprimtari e vlera që bënë jehonë

Bashkëpunim të veçantë kemi me Shoqatën Atdhetare “Dukagjini” Shkodër, Ndue Sanaj, i cili është anëtar nderi i Manifestimit “Dita e Plisit”. Kjo shoqatë për çdo vit nderon me medalje e mirënjohje më të merituarit gjatë periudhave të ndryshme historike.

Bashkëpunim patëm edhe me Shoqatën për shkencë dhe Kulturë “Pellazgët” me qendër në Tetovë “Dita e plisit të bardhë” kryetar –prof. Shefki Selami dhe iniciativa në themelim “Dita e Plisi të bardhë” në Preshevë drejtuar nga Xhemaledin Salihu.

Qëllimi i manifestimit “Dita e plisit” është të arrihet në nivel kombëtar të organizohet një datë me emrin dita e plisit shqiptar, në të gjitha trojet shqiptare dhe diasporën shqiptare. Pothuajse në shumicën e manifestimeve merrte pjesë edhe mbledhësi i folklorit e rrëfyesi i mprehtë i anekdotave, Sali Zogiani. Po ashtu, në secilin manifestim ka pasur grupe rapso-

dësh në veshje kombëtare.

Vlerë të veçantë manifestimit i kanë dhënë kumtesat e trajtesat shkencore, të mbajtura për një dekadë rresht, nga etnologë, studiues të folklorit, intelektualë e të tjera.

Trajtesat dhe studimet ngërthejnë aspekte jo vetëm historike apo letrare të interpretimit të krijimeve artistike, poezi e tekste të letërsisë gojore apo të Kanunit, po edhe shtrirje në fusha të tjera, siç janë antropologjia, etnografia, folkloristika, apo edhe semiotika dhe gjuhësia. Punimet u zgjeruan me trajtimet tematike kushtuar vlerave të traditës, po edhe të karakterologjisë tradicionale, siç janë arma, nderi, veshja, kultura e dëgjimit në traditën popullore; ose të tjera si figura e pleqnarit shqiptar, apo figura e rrëfimitarit dhe e anekdotistit shqiptar. Pothuajse shumica e këtyre shkrimeve shtjellojnë edhe ritet e traditat shqiptare që kanë të bëjnë me plisin, me jetesën e qëndrimin në kullë e me funksionin e saj, rite e ceremoni që ndriçohen gjithandej tek trajtimet tjera.

Së bashku kundrohen historikja dhe aktualja, festivja dhe estetikja, ritualja dhe funksionalja, empirikja, vëzhgimi i drejtpërdrejtë dhe përsiatjet shtjelluese, kombëtarja dhe regjionalja. Së këndejmi, nuk ishte e lehtë të përdoren terma adekuatë nga shumë fusha të dijes; por gjithnjë me kërkesën që të ruhet komunikimi sa më i kapshëm me audiencën dhe me lexuesin. Kësisoj, përfshihen edhe kronika, reportazhe e portretizime e që e përplotësojnë kuadrin e përgjithshëm të librave.

Do theksuar edhe dy veprimtari tjera me vlerë: orët letrare, në të cilat ka mbizotëruar poezia për plisin, si dhe botimi i librit "Dita e plisit" një herë në vit. Me autorësi të Ismet Krasniqit-Lalës e Prend Buzhalës. Deri këtë vit dolën nëntë ekzemplarë, ku janë përfshi kronika, informacione, reportazhe, kumtesa e studime kushtuar plisit, fotoalbume, shkrime përkujtimore për figura që kanë qenë aktivë në këto manifestime, intervista e të tjera. Po ashtu, do përmendur se janë afro 300 poezi që janë lexuar në këto manifestime. Librat përfshijnë mbi njëmijë foto nga manifestimet. Shumicën e manifes-



Pjesëmarrës në veprimtarinë "Dita e Plisit të Bardhë", në Boletin

timeve i kanë përcjellë disa qendra televizive nga Prishtina apo ato lokale, kurse janë bërë incizime dhe janë përgatitur dokumentarë specialë kushtuar manifestimeve. Pothuajse për çdo vit kemi qenë të ftuar në intervista nga disa televizione për t'i paraqitur rrjedhat, veprimtaritë dhe rëndësinë e këtij manifestimi.

Kudo që është mbajtur ky manifestim, ka krijuar frymën e bashkëpunimit me atë mes, ka ngjallur entuziazëm festiv tek të pranishmit dhe ka përhapur jehonën pozitive për tradita tona dhe për plisin si shenjë e reliktove nacional. Nëse në nisje qe përdorur motoja "Ne e nisëm, ju të tjerët vazhdojeni" (më 2014), këtë vit kulmoi një moto tjetër: "Plisi në UNESCO", ku u bënë nënshkrimet, me tekstin përcjellës, për t'ua dërguar qeverive tona në Prishtinë e Tiranë, që ta dërgojnë në UNESCO.

4. Kulla dhe plisi: relikte kujtese e trashëgimie dhe vende pelegrinazhi

Në të kaluarën pushtuesit ndoqën librin shqip e arsimin shqip, nuk i lejuan të zhvillohen publikisht. Një institucion më vete, prandaj, ishte Kulla. Ajo zëvendësohte, me oralitetin e saj, institucionin edukues me anë të këngës folklorike, rapsodisë dhe tregimit popullor, zëvendësohte institucionin e kuvendeve, atë të shkrim-leximit dhe të përcjelljes së ngjarjeve. Hapësira e këtyre fushave ishte rrudhur tragjikisht.

Akademik Mark Krasniqi thekson: "Kjo ka qenë e vetmja mundësi për t'iu lënë porosinë dhe trashëgiminë kulturore dhe historike brezave të ardhshëm... Me këtë rast duhet përmendur zgjuarsinë e fshatarit shqiptar, i cili mban mend shumë dhe di të flasë me respekt e bindje për atë që tregon".

Erdhën mandej doke e ngjarje, dhe të tilla u ruajtën si porosi dhe trashëgimi. Plaku shqiptar ka përcjellë porosinë dhe përvojën e tij brezave të rinj.

Kulla shqiptare lidhet edhe me traditën e mikpritjes, lidhet me nderin e burrit, me

faqen e bardhë, me besën, me trimërinë, me zemërgjerësinë e bujarinë, dhe gjithsesi, me atdhedashurinë.

Kulla lidhet me Kanunin e Lekë Dukagjinit, me normat shoqërore, juridike, ekonomike, madje dhe etnografike e të tjera. Kanuni shqiptar thotë: "Shpija e shqiptarit ashtë e Zotit dhe e mikut!"

Te Kanuni shqiptari obligohet: "\$.294. Zotnija do të kujdeset me ndertue nii ksojë, \$.mdheshkë a kullë per bulg e per shpiarët e ti)."

Kësisoj, në secilin manifestim u përcollën traditat pozitive të kombit tonë.

Tashmë ato janë kulla-muze, por ato do ta mbajn edhe një kujtes tjetër, atë të plisit dhe manifestimeve që u mbajtën në to.

Kulla dhe plisi janë relikte kujtese e trashëgimie. Janë edhe vende pelegrinazhi që ruajnë kujtesën e kombit, ruajnë lashtësinë dhe trashëgiminë.

Shkrimtari Prend BUZHALA



AT DANIEL GJEÇAJ, NJË VISAR I KULTURËS KOMBETARE, AI QË LA NJË BIBLIOTEKË TË RRALLE, DHURATË PËR SHQIPËRINË

Daniel Gjeçaj, lindi me 14 tetor 1913, në fshatin e Thethit, të krahinës së Shalës, Dukagjin dhe ka ndërrua jete me 30 gusht 2022, në Romë, frat françeskan, studiues, publicist dhe shkrimtar shqiptar.


Emri me të cilin e pagëzuan ishte Mark, i biri i Prekë dhe Kate Vatës. Mësimet e para të shqipes dhe të fesë i mori prej famullitarit, P. Dedë Bërdicës.

Më 1924 bien në Shkodër dhe hyn në kolegjin e françeskanëve, dhe më pas vijoi në liceun "Illyricum" ku kishte mësues Fishtë, Harapin, Prennushin, Shllakun, e të tjerë. Me 23 tetor 1932 vesh zhgunin, me 1933 kryen rishtarinë, me 1936 studimet liceore. Mbas këtyre nis pjesa e dytë e përgatitjes me studime jashtë Shqipërisë. Kështu më 1936 dërgohet nga eprorët e vet në Kuvendin e Sh' Bernardinit në Sienë dhe qëndron aty deri me 1939, kur më 25 korrik shugurohet meshtar. Vitin akademik që vijoi u dërgua në Fuldë të Gjermanisë[3], të parë e kuvendit t' atjeshëm i propozuan të vazhdonte studimet ku të dëshironte por ai zgjodhi të kthehej.

Me të kryer studimet vjen dhe mban meshën e parë në fshatin e lindjes, emërohet drejtor i Bibliotekës Françeskane deri më 1941 dhe më vonë zëvendës drejtor i kolegjit françeskan. Më 1942 Provinca e dërgon në Itali për të ndjekur me korrespondencë për shkencë biologjike, por u kthye vitin e ardhshëm në vjeshtë me të kapitulluar Italia[1]. Me mbylljen e instituteve fetare në Shkodër shkon më 1946 si famullitar në Plan të Dukagjinit. Më 1948 arratiset në Jugosllavi me Martin Caranj, rapsodin Gjergj Llumi dhe tridhjetë e sa nacionalistë të udhëhequr nga kapiten Gjon Destanishta. Nuk pranoi për të bashkëpunuar me UDB-në për këtë arsye u dërgua së parit me punua në hekurudhë në Barashumanoviq e mandej asistent i inxhinierit gjerman Vogël, rob i luftës, në Fushë të Zezë afër Podgoricës. Kaloi në Herzegovinë e Surdulicë e mandej iu bë e mundur të ushtronte mësuesinë në katundin e Preshevës ku mësues Marku u prit mirë. Më 1955 i ndihmuar nga Ernest Koliqi kalon në Itali, ku vendoset në Toskanë, në një provincë minoritike.

Komiteti "Shqipëria e Lirë" e thërret si përgjegjës për kulturën dhe i jep detyrë të ribotonte eposin fishtjan "Lahuta e Malcís", e P. Danieli bashkë me Petro Vuçanin e korrigjon dhe boton më 1959. Para se të zinte vend më 15 korrik 1970 në famullinë e Shën Gregorit VII në Romë, ka qenë sekretar i At Angelico Lazzari në Kurien e përgjithshme (1961-1965), ndërsa nga 1965-1970 jeton në Shën Pjetër në Montorio. Bashkëpunon dendur me Ernest Koliqin për të botuar tek "Shëjzat" artikuj, dhe iu dëgjua zëri shpesh ndër programet e Radio Vatikanit në gjuhën shqipe bashkë me Dom Zef Shestanin.

Zhvillon konferenca për lirinë e po-



At Danjel GJEÇAJ, Zëri me dëgjuar i mërgatës shqiptare Evrope spiker ne Radio Vatikan.

pullit shqiptar deri në ShBA. Ma vonë u emërua prej Selisë Shenjte si përfaqësues i katolikëve shqiptarë në mërgim. Shërbesën e tij meshtarë e zhvilloi pranë Famullisë së Shën Gregorit VII, ndërsa ishte edhe asistent i U.F.S.H. të famullisë Santa Maria Mediatrice dhe të famullisë Santa Maria della Perseveranza.

Në këtë gjysmë shekulli që jetoi në Perëndim, së bashku me dy fretër tjerë shqiptarë, Prof. Jakob Marlekajn në Bari e Dr. Paulin Margjokajn në Vjenë, mblodhën libra, dorëshkrime, dokumente duke formuar rishtas atë që u bë bërthama e bibliotekës së re françeskane në Gjuhadol.

At Gjeçaj si studiues i mirëfilltë i thellë në mendime e virtuoz si akademik la pas një bibliotekë tejet të pasur që përbën një thesar të vyer të kulturës shqiptare. Kjo bibliotekë që u kthye në Shqipëri përnjëherë me trupin e pa jetë të atit të shenjtë, është ngritë me një mijë e një mundime, duke i mblledhë fashikujt si këmba qelbin, duke kursyer edhe leket e fundit të falura nga besimtarët, vetëm e vetëm për të vënë në vend e çuar më tej traditën e bibliotekës së famshme të fretërve që ishte

djegur e përvëlur nga zjarmia e kohës.

Në këtë bibliotekë, të cilën e paktoi të tërën me duart e veta, Ana Luka shprehet se "mund të gjes gjithçka që ka të bëjë me Historinë e Shqipërisë, me historinë e Kishës Universale e Shqiptare, e sidomos me provincën françeskane".

At Danjeli ishte një nga të abonuarit e parë me enciklopedinë e Tercianit të cilën e kishte të plotë së bashku me fjalorin enciklopedik italian, ashtu siç kishte të plota enciklopeditë më të rëndësishme të kulturës e të arteve të vendeve të ndryshme të botës, siç kishte të gjitha gramatikat e shqipes, të gjithë fjalorët dhe botime të letërsisë shqipe, që nga botimet e 6 veprave të para të Naimit tek botimet e para të Fishtës, Lasgushit, Nolit e të tjerëve.

Për Fishtën pati krijuar një raft të veçantë ku gjendeshin pa asnjë përjashtim të gjitha volumet e veprave të poetit tonë kombëtar.

Në bibliotekën e At Danjelit studiuesi kishtar mund të gjejë gjithçka që nga Etërit e Kishës (Protologjia), Enciklopedinë Katolike, Enciklopedinë Shenjtërore, Historinë e plotë të Kishës Universale,

Historinë e Papëve si dhe Yllyricum Sacrum, të cilën e mori dhe e fotokopjoi Biblioteka Kombëtare e Tiranës.

Në bibliotekën e At Gjeçajt studiuesi shqiptar mund të gjejë veprat e albanologëve më të shquar dhe koleksionet e plota të revistave më me zë si Albaninë e Konicës, Hyllin e Dritës të fretërve, Lekën e Jezuitëve, Shejzat e Ernest Koliqit e të tjera.

Kjo bibliotekë ka një arkiv tepër të pasur që hap faqen e parë nga më interesantet e më të panjohurat nga Historia e Shqipërisë, ndërmjet tyre edhe një Histori Shqipërie e shkruar në gjuhën gjermane nga At Paulin Margjekaj. At Danjeli kudo nëpër botë gërmoi nëpër arkiva e biblioteka për të gjetur e për të mblledhur me kujdes copat e Shqipërisë shpërndarë nëpër libra e letra. Kur pa se si u zhdukën librat nga sytarët dhe gjithë vendi u mbush me kuti, nuk mundi të mos thoshte jo pa trishtim "Na ikën librat". Por mandej me shpresën se mos përmirësohej e do kthehej edhe ai vetë për gjithmonë në Shqipëri, shtoi "Punë e madhe, jam vetë bibliotekë" (Ana Luka, bashkëpunëtore dhe drejtuese e programacionit shqip të Radio Vatikanit).

Publicistika e Danjel Gjeçajt

Si publicist i talentuar me një aktivitet mbi 40 vjeçar, Gjeçaj la pas një trashëgimi të pasur publicistike. Ai, penën e tij të mprehtë e vuri gjithë jetën në shërbim të popullit të vet, duke denoncuar diktaturën dhe duke luftuar për të shpëtuar kombin nga mynxyra e ateizmit bolshevik dhe vetëizolimit të hekurit, kur shqiptarët mendonin se i kishte harruar edhe vetë zoti. At Danjeli nuk e humbi kurrë shpresën se Krishti do të kthehej një ditë në Shqipëri së bashku me lirinë, prandaj për këtë u lut, punoi, shkroi e cicëroi në mikrofonin e Vatikanit, ai dha informacione, shkroi artikuj e pamflete të fuqishme në gjuhët kryesore të botës dhe i nisi në të gjitha selitë që ishin krijuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut duke u ankuar për fatin tragjik të bashkëkombësve të vet, publicistikë që një ditë lusim zotin ta kemi të plotë në duart tona, për të hedhë dritë mbi një periudhë vërtetë tragjike të shqiptarëve, periudhë së cilës At Gjeçaj ia bëri radiografinë që atëherë kur ne kishim braktisë totalisht rrugën e Zotit. Kushtrimi i të varrosurve për së gjalli është padyshim njëri prej pamfleteve më të fuqishme të penës së Gjeçajt që krahas vlerave propagandistike të pakrahësueshme kishte vlerat e një proze të thellë me një stil të tepër të lartë artistik.

Danjel Gjeçaj, një përkthyes i talentuar duke qenë gjithnjë në kontakt të ngushtë me besimtarët shqiptarë, të cilët e kërkonin t'u bekonte martesat, për t'u vojuar të dashurit në fill të mordes, për t'u pagëzuar foshnjat, atij i lindi nevoja t'i vihej përkthimit të liturgjisë, e cila pa

vonuar u bë pasioni kryesor.

Së pari përktheu e botoi Mesharin e Kremteve më 1966, dhe më pas ndonëse i kishte kapërcyer të tetëdhjetat, bëri gati Mesharin e plotë në gegnisht me 2 mijë faqe dhe ju vu punës për përkthimin e plotë të Testamentit të Vjetër, faqja e fundit e të cilit ndalet te libri i Numrave, përkthyer vetëm pak ditë para vdekjes. Ia doli të përkthente pjesën kryesore të Biblës. E në këtë përkthim shkëlqen për mjeshtëri të posaçme një nga copat më mahnitëse të mbarë letërsisë botërore "Kanga e Kangëve". Prej Testamentit të Ri përfundoi Punët e Apostujve e copa të tjera të rëndësishme. Nga gjithë ky material voluminoz me mijëra e mijëra faqe, mundi të botojë vetëm librin e Psalmeve 1999 duke lënë pas në duart e bashkëpunëtorëve të vet besnik pjesën tjetër që me siguri do të botohet së shpejti, në të kundërt do të ishte një humbje e madhe për kulturën shqiptare dhe shkelje amaneti njëkohësisht.

At Gjeçaj vdiq me një brengë të thellë në shpirt që Meshari i përkthyer aq mjeshtërisht nuk e pa dritën e botimit vetëm se që përkthyer në dialektin gegënisht. "Nëse vullnesa e Zotit është që të vdesë gegnishtja, le të vdesë me një Meshar, ashtu si me një Meshar pati lindur". Kështu u shpreh Gjeçaj përballë çensurës së pamotivuar që frenoi botimin e kësaj kryevepre kishtare të shqipëruar në një gegnisht të kristaltë e shumë të artikuleshme. At Danjeli dhe edhe një kontribut të çmueshëm për historinë e Kishës. Në arkivin e tij ruhen shumë studime që hellin dritë mbi periudha të ndryshme të unguillizimit shqiptar e sidomos mbi fillimet e përhapjen e Urdhrit Françeskan.

Shkrimtari i pasionuar

At Gjeçaj shkëlqen edhe si shkrimtar i pasionuar, si mjeshtër i skalitjes së fjalës së shkruar, me plane të gjera krijuese dhe me fryte të rëndësishme prodhuese. I pari fryt i rëndësishëm i programit të tij ambicioz që botimi i Lahutës së Malësisë, 1958, me përmbledhje këngësh, me numërim vargësh, me fillim fjalësh e frazash të vështira për t'u kuptuar menjëherë prej atij që nuk e njeh në thelb gjuhën e pastër të maleve Jutbinase. "Lahutën" e ribotoi më 1989, "Andrrën e pertashit" më 1959 e më 1995 veprën "Valë mbi Valë" të At Anton Harapit, shifet qartë se sa shumë punoi për botimin e veprave të bashkëvëllezërve të cilat i pajisi me ilustrime sqaruese e komente të veçanta, duke lënë pas dore veprat e veta, një pjesë e mirë e të cilave i mbetën në dorëshkrim.

Libri i parë i tij më i rëndësishëm është "Gjergj Fishta, jeta dhe vepra", 1992, duke u bërë në moshën 80 vjeçare biografi i parë i At Gjergj Fishtës së madh. At Fishta është i pranishëm në një numër të madh shkrimesh të At Gjeçajt, të botuara e të pabotuara. Po kujtojmë vetëm disa fragmente nga fjalimi që mbajti në rivarrimin e eshtrave të Fishtës në Shkodër, ku s'ia priti gjë hovin e rrugës, ndonëse ju desh të shtegtonte në kohë dimri, nuk pyeti aspak për vitet që kishte mbi supe dukagjinasi i natyralizuar si engjëlli.

"Eshhtënat e kësaj dore sot në vend të vet i vendojmë dhe breznive të ardhëshme trashëgim ua lëmë, se pa kte dorë shqiptari "epope" s'do kishte pasë as me lahutë kurr gishtat s'do t'i kishte dridhë për të këndue

homerisht ... Marash Uçë, Ali Pashë e Dedë Gjon Lul, Patër Gjon e Tringë. Emni i tij gjallnon breznin me breznin. Gati një gjysëm shekulli harresë e imponueme. U rrafshue vorri, por nuk u zhduk emni, shtatorja e tij vigane u përjashtue prej panteonit të shkrimtarëve prej Olympit të poetëve, por Fishta gjalloj i kerntheste ndër zemrat e ndër to kthjelloj rrajët e rriti dashni. Fara që s'vdes nuk ep fryt tha mjeshtri hyjnor i ne katolikëve".

Nga krijimtaria e tij e mirëfilltë letrare vlen të përmend tre libra me portrete e tregime nga jeta e Dukagjinit.

*Prel Tuli i Salcës, në vitin 1990;

*Mehmet Shpendi e Mark Sadiku i Shalës, në vitin 1996;

*Te Del Kiri" në vitin 2000.

Mbeti në dorëshkrim vëllimi i katërt "Dikur në Dukagjin", e shumë shkrime të tjera për njerëz, doke e tradita të vendit, nga lindi projekti i tij ishte të rrëfente në prozë virtutet e popullit të vet.

Shumë shkrime janë të shpërndarë në revista e gazeta të kohës së tij të mërgatës ndërmjet të cilave veçojmë "Shejzat" që ishte bashkëpunëtorë i rregullt i saj.

I pajisur me kulturë të gjerë At Danjeli shpesh iu kushtua edhe punës për komentimin e kryeveprave të letërsisë shqipe e të huaj. La në dorëshkrim komente të poezive të Fishtës, sidomos së "Anzave të Pernasit", sepse mendonte që me kalimin e kohës dhe zbehjen e kujtesave, shumë fjalë e shprehje të kësaj veprë të pashoqe satirike do të mbeteshin të pakuptuara ose do të komentoheshin keq nga kritikët në veprat e të cilëve hamendjet shpesh bëjnë hatanë.

Komentoi shumë krijime të poetit të madh, At Bernardin Palaj, të Ernest Koliqit, të Martin Camajt e të disa poetëve të huaj të lashtë e modern, ndërmjet të cilëve kishte shumë për zemër poetin hungarez Giulio Iliesh dhe oden e tij "Tirania".

At Danjeli komenton "Në oden Tirania", në të cilën autori shpreh me dihamë shpirti dhe përshkruen me gjak të zemrës së vet e të popullit që, si ai pësoi të njëjtin fat, rulin ritmik të atij kompresori me hyllin e kuq e drapër e çekan, i cili nga Rusia të shkeli e dërmoi, thërmoi e ngjeshi në brumë të marksizmit proletarë, popuj e fise...".

Kumtuesi i manifestimeve të mëdha

Danjeli mori pjesë aktive në shumë manifestime kulturore të shqiptarëve nëpër botë, nga Italia në Amerikë e Australi.

Mbajti kudo kumtesa me tema nga historia e kishës dhe e kulturës shqiptare. Nuk pushoi kurrë së shtegtuar në botë si sensibilizuesi i opinionit të krishterë për fatet e Shqipërisë, ja një citat i mbajtur gjatë një konference në Romë, në të cilën morën pjesë përfaqësues të Konferencave Ipeshkvnore nga e gjithë bota. "Një realitet i idhtë, tragjedia e një populli që po vdes po jehonë pa mëshirëeshtë një komb i mbyllur prej 33 vjetësh në kam përqëndrimi, është një popull që vuen nën skllavërinë ma të egër që ka njoftë ndonjëherë historia e njerëzimit, është një kishë e lashtë me zanafillë apostolike e bame rrafsh me tokë prej mensisë së çfrenueme të komunizmit. Nuk pretendojnë katolikët shqiptarë të burgosun në Shqipërinë politike

një lagër të vërtetë çfarosje, ndihma materiale, presin nga bota e lirë, nga Ati i përbashkët tepër i ndjeshëm përballë vuetjeve të bijve të vet, nga ju barinj e përfaqësues të Kishave Lokale, atë ndihmë që në të kaluemen e ka shpëtue Shqipërinë si komb, i ka ruejtë fenë, mira herë të kërcënueme në ktë tokë të pa fat, udhëkryq kulturash teatër ndeshesh të përgjakshme ndeshesh për hegjemoni. Zani i Atit të shenjtë që vuni në dukje martirizimin e kishës shqiptare (fjalimi i atit të shenjtë 24. 12. 1974) bani shumë ma tepër se ka ba bota politike në kto tri dekada në dobi të katolikëve shqiptarë".

Na kërkojmë solidaritet, ndihmë morale e lutje.

Ndër veprimtaritë e organizuara nga ai vetë në Romë mund të përmenden kremtimet madhështore me rastin e 100 vjetorit të lindjes së At Gjergj Fishtës. Për herë të fundit që ftuar të merrte pjesë në Shkodër, ku do të fliste mbi figurën e fratit shqiptar. Sëmundja e pengoi të merrte pjesë, por kumtesën do ta shkruante, e do ta niste, të cilën e mbyllte me kto fjalë simbolike që nuk kanë nevojë për koment: "Po e mbylli fletën teme me një anekdotë të shkurtër të vjetës 1947. Uleshim prej Planit në Shkodër bashkë me shtegtare të fshatit ku ishem famulltar. Në Leporosh ndalemi me pushue, aty ku udhëtarët e maleve vendin e pushimit e njoftin me emrin "vorri i fratit". Dy gra vendase na dalin përpara. Përshëndeten si ashtë dite me ne, tue nisë te Patri. Ne hatrit zotit i bekuem që u paska mbetë ende fara. Zoti mos na lashtë pa ju. Dy fisniket s'ishin katolike. Nuk më takon mua me thanë, por fjalët e martirit frat, që përmenda sipër janë penelatat mitologjike të filozofisë së fratit shqiptar përpara të cilit besoj unë shqiptari i vërtetë s'gabohem me thanë: Mos na len o Zot pra frat.

Kush asht shqiptar i vërtetë, Dukagjinit nuk ia ven kamen"

Në Shqipëri mundi të kthehej pas 40 vjetësh azili politik, dashuria për atdheun dhe krenaria e të qenit shqiptar e bënë të palëkundur në qëndrimin e tij për të mos pranuar asnjë shtetësi tjetër, shtetësi të cilën ia kishin ofruar gjermanët, austriakët dhe italianët.

Mospranimit i këtyre shtetësive të ofruara u bë pengesë e madhe për të siguruar udhëtimin e tij në Shqipëri, pas shembjes së mureve rrethuese pasi At Danjeli nuk dispononte asnjë lloj dokumenti identiteti të shtetit shqiptar, ndërsa nga ana tjetër sigurimi i shtetit kishte arritur deri sa ta çregjistronte që të mos figuronte si shqiptar, dhe ndofta sikur të mos ishte ndihma e ambasadorit të Vatikanit Pandeli Pasko, At Danjeli zor se do të ishte lejuar të kthehej në Shqipëri pasi nuk kishte asnjë dokument që vërtetonte se ai ishte shtetas i Shqipërisë.

Mbresëlënës, emocionues, ngushëllues deri në pikëllim ishte kthimi i tij në Shqipëri. Ai, në këto momente, do të shprehej: "Atë ç'mund të ndjejë një i verbër kur i rikthehet drita e syve, atë ndjeva edhe unë sot kur m'u kthye e drejta të shkeli tokën e atdheut tem, të marr frymë në ajrin e pastër të Shqipërisë teme, të pi ujin e kristaltë të gurrave të vendlindjes sime në Theth të mohuara nga sinonimi i së ligës".

U mallëngjye, rrëfejnë klerikët që e pritën, kur erdhi në Shkodër Locen e tij dhe nuk gjeti as Fishtën dhe asnjërin nga

vëllezërit e mëdhenj të Urdhrit Françeskan. U ngashërye dhe shpërtheu në vaj kur nuk gjeti dot as varret e tyre sa për t'u vënë një tufë lule tek kryqi i varrit për të cilin ishin flijuar amshueshëm.

U pikëllua deri në trishtim kur pa me sytë e vet degradimin deri në shpërftyrim të shqiptarëve bashkëkohorë, ndërsa për mynxyrën e '97-ës tha: "Edhe ata që do të lindin pas 2-3 brezash do të jenë kokë ulur përpara historisë".

Italianët nuk deshën ta linin të vinte në Shqipëri për shkak të shëndetit të rënduar, por forca e amanetit triumfoi mbi moshën e thyer e kohën e trazuar. At Danjeli do të deklaronte tani e ndjej veten vërtetë si në parajsë, gjithë jetën e çova në purgator duke pritë këtë çast fatlum. Evroperëndimorët me syzet e errëta çuditeshin si ka mundësi që nga viset më shkëmbore të një vendi të vogël si Shqipëria të dilte një personalitet i këtyre përmasave, me një kulturë aq të gjerë sa me zili ishin të detyruar ti hiqnin kapelën.

Italianët thoshin, ja ku e keni kardin-alin ju shqiptarët.

E kam dëgjuar me veshët e mi, e kam shkruar me karbon dhe kam gozhuar mirë në kujtesë tek po debatonte me disa intelektualë dhe të moshuar nga Dukagjini, të cilët mallkonin ata të paudhë që me punët e liga po ja nxijnë faqen Dukagjinit e për fatin e tyre të keq quhen si plëngprishësit e Shkodrës. "O vëllezër, unë po shoh me sytë e mi sa poshtë ka ra emni i fisit të shqiptarit, por ju e dini mirë se ujë i turbullt ngre pezull kalbsuçat e plehrat, por po ua them se as shqiptarët në Evropë as malësorët në qytete nuk janë si reklamo-hen as nga fobizmi evropian as ai qytetas këtu. Në qoftë se ka një traditë të pastër atdhetare, në qoftë se ka mbete ndonjë fije burrnje në vatrën e shqiptarit, ajo gjendet së pari në dejet e dukagjinasi, i cili asnjëherë as me hiri as pa hiri nuk u divorcua me Jezusin".

Ndërsa refugjatëve të parë që shkëlën në Apenin At Danjeli në vitin 1991 u dha këtë këshillë. Refugjatët shqiptarët që kanë kaluar nëpër duar të mija deri në vitin 1991 janë me mija, u kam thanë gjithmonë: "Secili prej jush në mërgim mban me veti kombin e Shqipërisë, të cilin bota ka me njoftë nëpërmjet jush. Po i latë nder vedit, i keni lanë nder vendit e kombit, po u shnderuet keni shnderue Shqipërinë e shqiptarët. Këtë parim e kam ndjekë për vedit dhe jam mundue si shqiptar, e sidomos si meshtar françeskan, mos mej lanë dangë Kombit, fisit, as petkut që mbaj".

Kolegu i vuajtjeve dhe i besimit At Ambroz Martini në ligjëratën e përmotshme mbi arkivolin e meshtarit u shpreh: "At Danjeli nuk u dorëzua kurrë përpara fatit të keq. Me forcën që i jep Krishti, ai vuri në jetë karizmat e tij, karizma hiri, karizma inteligjence. Ai jetoi në tunelin e zi të shpresave të humbura, pa i humbur këto shpresa, me sigurinë se shpresa e Krishtit është më e fuqishme se çdo tirani. At Danjel Gjeçaj ishte luftëtar i përjetshëm i kryqit dhe i çështjes kombëtare shqiptare, idealist i idealit të Shqipërisë Etnike që së bashku me nënë Terezën ishin zërat më të fuqishëm të kauzës shqiptare në botë".

Roza Pjetri

Kush vallë do ta bënte një sakrificë të tillë?!

- Banorët e Pepsujave dhe Policia e Dukagjinit shpëtojnë turistin gjerman nga vdekja -

Në vendin e quajtur Kodra e Kunjit, pikërisht në bërnylin ku dega kryesore Stupja bashkohet me Lumin e Shalës, përballë Gurit të Lekes, si një portik mbi resortin e Vau Blinit (Lumi i Shalës) një turist gjerman që po udhëtonte drejt fshatit të Pepsujave, është rrezuar e ka rënë në një greminë të thellë karbonike, duke thyer brinjët dhe pësuar hematoma të rënda trupore.

Ka qene bashkëshorti, i cili pas katër ore udhëtimit ka kërkuar ndihme në fshatin Pepsuj, të NJ. Ad. SHOSHI. Si gjithmonë nuk ka munguar humanizmi dhe sakrificat e pa zakonte për epokën moderne, i banorëve Kole Zefi, Mark Fiku, Gjergj Kodrari dhe një nip i këtij të fundit, që kanë shkuar e kanë gjetur të lënduar në gjendje të rëndë shëndetësore dhe menjëherë e kanë vënë në vig (Barele supi e malësorëve) dhe duke udhëtuar si në filma heroik për mbi katër ore mes temperaturave përvëluese, terrenit të rrëpirët ku shtegtojnë vetëm dhite e egra. Në ndihme të tyre janë vene edhe Inspektoret e Policisë Sokol Kroni e Gjergj Ndershtiqej dhe në orët rreth mesnate së datës 20.07.2023 e dëmtuara e rrëmbyer nga kthetrat e vdekjes ka mbërritur në Urgjencën e Spitalit Rajonal të Shkodrës, e cila tashmë është jashtë rrezikut për jetën. Është rasti i pestë që bashkësia dhe policet e Postes së

Dukagjinit u vine në ndihme dhe shpëtojnë jetë turistëve të huaj vetëm gjatë këtij sezoni deri te tanishëm.

As një gjerman, francez as evropian perëndimore, nuk do bënte këtë sakrificë. Po mund ta bënte shteti, por jo as një qytetare, nuk do të linte çdo pune



tori të përvitshme shqiptare, që në tokat tuaj të begata kanë perënduar prej shumë vitesh. As kund në botë turistët (tuaj ne shumë raste aventurier të natyrës) nuk ndihen më të sigurt, më të mirëpritur dhe më të ndihmuar në çdo rast fatkeqësie se në Shqipëri dhe sidomos në malet tona.

Mark Fikun e Gjergj Kodrarin dhe policët Sokol Kroni e Gjergj Ndershtiqej, është një bekim hyjnore i humanizmi, sakrificat të pa zakonte, që buron si krojet bore nder zemrat bujare shqiptare!

Ku jeni ju medime zi ndjedhese që heshtni si qyqe për gjithë këto raste fat-

dhe ti përvishej një beteje epike harushiane si kjo. Ju evropian mondan që popullin baballarë të Evropës e keni veshur shpesh me aureolat më të shëmtuara të egërsisë, duke i përbuzë si qytetare të rangut të tretë. Ju miq të mirë a keni sy me pa?! A keni gojë me tregua këto his-

Tutem se rendja në trok të pa ndalur drejt ëndrrës Evropiane, do të na çoj në bjerren e bujarisë, humanizmit, karakterin të çeliktë burror, kultit të familjes dhe besës, që e kanë çuar zonjën e vjetër në krizë të rëndë morale.

Mirënjohja për banoret Kole Zefin,

bardha, ndërsa patet bombarduar ekranet, me vrasjen tragjike të të çmendurit Sakol Mjaca, apo vetëm lajmi i zi gatuhet në kuzhinat tuaja?!

Prele Milani

Poeti Kolë Kodra

Kush është poeti Kolë Kodra?

Kole Kodra ka lindur me 20 prill 1970, i biri i Gjergj Jake Kodra e Lulë Nikë Kodra, në fshatin Gegaj të krahinës së Shllakut. Babai i ka punuar në detyra shoqërore të ndryshme, ndërsa nena shtëpiakë dhe nuk jetojnë.

Kola shkollën fillore e ka mbaruar në

fshatin Gegaj, ndërsa atë tetëvjeçaren dhe të mesmen në Shkollën Bujqësore, Shllak, në 1990. Në vitin 2010, jam diplomuar në "Universitetin Luigj Gurakuqi" Shkodër në degën: Gjuhë - Letërsi, me titullin: Mësues i Gjuhës Shqipe dhe i Letërsisë.

Kola ka punuar nga viti 1993 deri në vitin 1997, Mësues gjuhe dhe letërsie në

Shkollën e Bashkuar (Gjimnaz) në krahinën e Shllakut. Nga 1997 e në vijim, punon punonjës i thjeshtë në Hidrocentralin e Komanit.

Kola është i martuar dhe ka tre fëmijë.

Kola është autor i 10 librave artistik, të cilat përfshijnë: Poema, poezi, lirikë, prozë dhe aforizma.

Vibrante. Poezi 2012

Koha flet. Poezi 2013

Ku flet veç e vërteta. Lirika 2014

Vibrante, ribotim. Poezi 2015

Në trotuaret e kohës. Lirikë 2015

Maja të ujëvarta. Poezi 2016

Fortesatorët. Poemë 2016

Invektivë për introvertët. Poezi 2017

Vite që ngasin. Lirika 2019

Ekse maji. Aforizma dhe lirika 2020

Deh eros. Lirika 2020

Arbër Shytani



Një zë i veçantë në eseistikën dhe kritikën letrare të sotme

(Reflektim rreth librave e shkrimeve të prof. Kadri Ujkës)

Zotin Kadri Ujkaj e njoh prej vitesh, së pari, sepse jemi nga e njëjta krahinë, nga Malësia e Madhe: ai nga Kopluku i Sipërm e unë nga Bajza e Kastratit dhe jemi të lindur në pranverë të viteve '40, ai më 12 maj të vitit 1949 e unë, plot gjashtë vjet e një muaj më parë se ai. Kaq, mjafton për ta kuptuar respektin e ndërsjelltë, që kemi për njëri-tjetrin, dëshirat e mira dhe gëzimin që ndiej kur marr vesh se shkruan e boton artikuj, studime e libra me vlerë, që ka kryer me përkushtim e për shumë vjet radhazi, jo vetëm detyrën si mesimdhënës po edhe si drejtues, prej 2006-s, i ish-Lidhjes së shkrimtarëve, sot shoqata "Shkrimtarët dhe artistët" Malësia e Madhe" dhe që, për meritat e ndihmesat e tij, Malësi e Madhe e ka dekoruar me të gjithë titujt, në mundësi të saj, deri me titullin "Qytetar Nderi" i Bashkisë Malësi e Madhe, krahas bijve të tjerë të saj të mirënjohur, si Lukë Kaçaj, Nikolla Spathari, Rudi Vata e të tjerë. Sipas traditës së hershme e të mirë të maleve shqiptare, atij që është më i madh në moshë, i takon të jetë si "axhë" (xhaxha a çëço) i më të rinjve dhe unë, qoftë, edhe pse jemi parë e shihemi rrallë, secili "duke ruajtur dhentë e veta": unë duke ndjekur të folmet e dialektet e shqipes dhe shumëçka tjetër në fushën e gjuhësisë, kurse ai, duke u ngjitur me guxim krijues e prurje interesante në lëmin e krijimtarisë eseistike, kritikës letrare e si veprimtar shoqëror, e kemi dashur dhe e duam shoqishojnë. Vite më parë, kur do të ndiqte studimet e larta pasuniversitare, pata dëshiruar ta shtyja në krahun e gjuhësisë, porse ai e ndiente veten më të prirur nga letërsia dhe sidomos nga kritika dhe eseistika letrare. Bindem se paska pasur të drejtë.

Ai më ka përmendur shpesh në shkrimet e librat e tij, kemi qenë edhe në një komision të përbashkët për të parashtruar e argumentuar kërkesën që t'i jepej Ismail Kadaresë titulli "Qytetar Nderi" i Malësisë së Madhe. Hera e mbarë e pruri që, më në fund, ndonëse e kisha menduar e bërë "nijet" qëkur, t'i shkruaj disa rreshta për prof. Kadri Ujkaj, me rastin e përgatitjes për botim të librit të tij, më të ri, me titullin "Dritëhijet tona si thelbi ynë", ku kemi edhe "M. Madhe me dritëhijet e veta". Për ata që, ndoshta, s'i kanë lexuar të gjitha shkrimet e tij, po lejohem të përmend se libri që po dërgon në shtyp, krahas bashkëpunimeve si autor edhe i dy librave të tjerë, është në radhën e dymbëdhjetë librave të tij, deri nordbestseller, të mirëpritur nga lexuesi, si: "Ky krushk i qytetërimit të madh", "Helena Kadare", Shkodër, viti 2000, "Kurthi i fjalës", botues "Idromeno", Shkodër, viti 2003, "Kryqëzimi modern i gjenive", botues "Onufri", Tiranë, viti 2001, "Lukë Kaçaj", botues "Mokrra", Tiranë, viti 2003, "Korifenjtë në krizën e dritëhijeve", botues "Medaur", Tiranë, viti 2007, "Kur dashurohem me kultkoniunkturën...", botues "Idromeno",

Shkodër, viti 2011, "Kriza si dehja nga entuziazmi modern", botues "Rozafat", Shkodër, viti 2014, "Kush jemi...", ku po shkojmë...?!", viti 2017, "Deri kur...kundër vetvetes?!", viti 2020 si dhe "Dritëhijet tona si thelbi ynë", botuese "Fiorentia", Shkodër, në 2022-in.

Malësia jonë e Madhe, për të gjithë sa jemi bij të saj, si ata që rrojnë e punojnë në vendlindje, si shumë prej atyre që jeta i ka shpënë larg saj, në qytete të Shqipërisë apo edhe në qendrat e mëdha të Evropës e të Amerikës, madje deri në Australi, na përbashkon e na lidh në një hallkë atdhetarie, pikërisht, ndjenja se jemi bij të Malësisë, se emri i vendlindjes sonë, si pjesë e Shqipërisë dhe si vendi prej nga ka buruar ndër shekuj edhe "palca" e krenarisë dhe e dashurisë për At-dhe na afron shpirtërisht, edhe kur ndodhemi larg me trup. Do të ishte e vështirë, madje e pamundshme, të mbledhësh sot në një mjedis, apo tubim të gjithë ata "bij të xhubletës" që shkruajnë e botojnë shqip e për shqiptarinë e Shqipërinë, sepse ata janë të shumtë e të shpërndarë bukur larg, në Evropë e në mbarë botën. Gati nga çdo fshat i Malësisë dhe i Rranxave të Mbishkodrës ka sot poetë, shkrimtarë, gazetarë dhe njerëz të dijes me prurje e vlera interesante, që e krenarojnë vendlindjen e vet, Malësinë e Madhe "Nderi i Kombit". Nga Luisi i Koplikut të Sipërm është poeti e shkrimtari Sokol Zekaj, nga Gorajt e Kastratit, porse i larguar qysh herët në Shkodër e më pas në Durrës, është poeti e shkrimtari Nikolla Spathari, nga Zagora ishte romancieri i njohur Ramiz Lika, që u nda së gjallësh pak kohë më parë, kurse nga Bajza janë poetët Dodë e Tonin Kaçaj, si dhe Dakë Keqaj e të tjerë, vëllimet poetike dhe krijimet e të cilëve janë tashmë të pranishme në libraritë dhe bibliotekat e lexuesve shqiptarë. Nga Brruti i vogël i Kastratit është edhe Gjekë Marinaj, arratisur në vitet '90 për sherr të poezisë "Kuajt", i cili, jo vetëm nuk e harron vendlindjen, po edhe prej Amerike i blaton poezi e studime serioze, si vlera letrare shqipe. Dhe sot, poetë, shkrimtarë, gazetarë e emra të shquar të medias, me origjinë nga Malësia, ka aq shumë, saqë përmendja e të gjithëve do të kërkonte një hapësirë shumë të gjerë, po edhe jo të lehtë për ta ndërmarrë. Po themi vetëm atë që e kërkon rasti: zoti Kadri Ujkaj ka vendin e vet në logun e shkrimtarëve dhe veprimtarëve publikë të fjalës së shkruar e të folur në mediat e sotme në Shqipëri dhe jashtë saj. Para disa kohësh mësova se Akademia Shqiptaro-Amerikane e Shkencave dhe Arteve, New-York, e kishte pranuar edhe si anëtar të saj. Ai është një zë i veçantë, hulumtues i zellshëm dhe pohues i vlerave letrare, historike e etnokulturore të Malësisë si zonë dhe shumë më gjërë,

po aq edhe sy i mprehtë, kritik i guximshëm, gazetar dhe analist që nuk mënon të thumbojë edhe çdo gjë të pamirë e të padobishme, që vijon të na mbetet nëpër këmbë e na pengon të ecim përpara drejt shtigjeve të reja të jetës së sotme në situatën e lirive demokratike e të globalizmit. Për Malësinë, malësorët dhe bëmat e tyre trimërore e për bujarinë proverbiale të anëve tona ka shkruar shumë dhe, faktiki-



sht, askush s'ia ka kursyer as vlerësimet, as lavdërimet. Thëksojmë se Kadri Ujkaj, si studiues e publicist, është nga ata që, duke pohuar gjithçka të mirë të Malësisë e të malësorëve, në rrjedhë të shekujve, nuk mënon të kundrojë, madje dhe të fshikullojë, me objektivitet, duke pasur si hulli atë që, tekta e ka karakterizuar në shumë nga këndvështrimet kritike apo esetë e tij të mëparshme, na e sjell qysh në titullin e librit të tij antologjik: "Dritëhijet tona si thelbi ynë", si një psikanalizë e vetë shoqërisë. Drita, dielli e hëna e ndritshme, kanë qenë e mbeten kurdoherë edhe në onomastikën malësore, ku janë të shumta toponimet, si: Shkrepi i Diellit, Shkambi i Kuq, Rrasa e Kuqe, po edhe emërvendet me fjalën hije: Rranxa e Hijes, sikundër edhe epitete hijemirë e hijekeq; hijemirë, hijezi a hijezezë. Kjo do të thotë se, edhe në jetën e njerëzve, bëmat e tyre duhen parë në mënyrë dialektike, të mirat, apo drita dhe shkëlqimi, po ashtu edhe anët e errëta. Librat e tij, me ese, këndvështrime estetike, sikurse kundrimet të aspekteve të ndryshme të historisë, traditave dhe etnokulturës së Malësisë si zonë, po edhe, përgjithësisht, për ato që përjetojnë sot malësorët në Malësi e në diasporën e saj, synojnë të pohojnë të vlefshmen, të lartësojnë traditat e bukura të së shkuarës, po aq edhe apelon të shkohet më tej në kundrimet dhe vlerësimet objektive për jetën dhe përjetimet e Malësisë. Ai ka shkruar dhe botuar herëpashere artikuj problemorë, ese, publicistikë, sikurse përmbledhje antologjike, me tematikë të larmishme dhe interesante, që në zanafilën e tij si studiues dhe anëtar i Seminarit Shkencor Ndërkombëtar "Shkodra në shekuj", ku përsiat dhe hulumton dukuri me vlera estetike, historike, etnografike e etnologjike, siç shkruan edhe për zakonet e doket e hershme, në krahasim me du-

kuri të jetës së sotme; paraqet faqe të ndritura të trimërisë dhe traditave të Malësisë së Madhe "Nderi i Kombit", përmend dhe vlerëson burrat dhe figurat e njohura të saj, duke u ndalur sidomos në emra të mëdhenj të bijve të saj, si për këngëtarin e famshëm Lukë Kaçaj dhe për figura të tjera të shquara të Mbishkodrës sonë. Përtej kësaj, Kadri Ujkaj hedh vështrimin e tij kritik e të mprehtë dhe nuk mund të rrijë pa i fshikulluar edhe disa rrafshë, aspekte apo koncepte prapavajtëse dhe të papërshtatshme për kohën e sotme. Kam parasysh, krahas të tjerëve librin e tij "Kush jemi...", ku po shkojmë...?" (2017).

Librat e Kadri Ujkës lexohen me ëndje, fjala e tij rrjedh, herë me vrulle, si lumenjtë malorë, duke vënë përpara shumëçka të keqe, apo të shëmtuar, herë e qetë dhe e shtruar, por kurdoherë duke iu përmbajtur urtësisë malësore, që thotë: "Kafshatën e madhe haje aq sa mundesh, por fjalën e madhe mos e fol!". E, sa për qëndrimin kritik, natyrisht, prej mençurisë malësore, ai ka pasur si shtysë thënien, apo porosinë e pavdirë dhe të hershme të kritikës profesionale, objektive, apo të peshuar mirë: "Si ta presësh xhakëtën për vete, njashtu ma pre edhe mua!" Në urtësinë e pakundshoqe të gurrës popullore të Malësisë sonë, kritiku letrar profesionist, Kadri Ujkaj, ka thithur, qysh në moshë të njomë, mësimin: "Rri shtrembët, por fol drejt", prandaj ai, ashtu siç e thoshte poeti Ndoc Gjetja, kur sheh se "fort po shndrit e pak po nxe, kjo e vërteta përmbi dhe", shpesh edhe zemërohet e mpreh qëndrimin kritik, por gjithmonë pa sharje, pa teprime dhe duke lakmuar të zbotojë thënien e urtë: "Atë që nuk ta ka anda për vete, mos ia thuaj tjetrit!" Në esetë dhe këndvështrimet e prof. Kadri Ujkës, lexuesi i thjeshtë dhe ai i kualifikuar gjithherë shquan zellin e tij për ta thënë të vërtetën, dëshirën për të hulumtuar dhe nxjerrë në dritë vlerat e mira të Malësisë së Madhe Natyrore si dhe të malësorëve duke mbështetur dhe vlerësuar ato që janë pohuar e thënë mirë, po ashtu edhe pa ngurruar të kritikojë qëndrimet e shtjellimet e padrejta konkrete.

Më pëlqen se Kadri Ujkaj është edhe i afrueshëm dhe gjithmonë i lidhur me rrethet e krijuesve më të mirë, sidomos, të qytetit të Shkodrës, të Lezhës, të Tiranës, të Durrësit, të Kosovës e të Malit të Zi e të tjerë. Si një sodisfaksion vetiak dhe profesional i kam përjetuar kontaktet dhe daljet e tij publike, si gazetar dhe kritik letrar, përmes mediave vizive dhe botimeve në median e shkruar, me krijuesit dhe artistët më në zë, nga F. Kraja, F. Paçrami, D. Agolli, I. Kadare, R. Qosja, L. Kaçaj e të tjerë. Madje, cilësimin e tij si një zë i veçantë i eseistikës e kritikës së sotme letrare e mbështesim (vijon në faqen 13)

Ndahet nga jeta Albanologu dhe Akademiku i shquar, Bahri Beci

Lamtumirë Profesori ynë i nderuar Bahri Beci!

U nda nga jeta gjuhëtari, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, intelektual dhe personaliteti i shquar Profesor Bahri Beci. Përben një humbje të madhe jo vetëm për familjen, të afërm, miq e koleg, por dhe për të gjithë ata që e kanë njohur si dhe patën fatin e mirë ta kishin pedagog, profesor ketë intelektual të mirëfillte, që me pasion dhe përkushtim, ka bere një punë të vijueshme për ti pajisur nxënësit dhe studentet e tij me dije bashkohore në fushën e gjuhës, duke mbrojtur me pasion identitetin kulturor dhe gjuhësor të popullit shqiptar. Prandaj ne, që ishim nxënësit e tij i jemi shumë falënderues dhe mirënjohës Prof. Bahri Becit për punën e palodhur në fushën e studimit gjuhësor, por veçanërisht me ne nxënësit e tij për tu bere njerëz të mire e atdhetare, që ta duam atdheun dhe popullin tonë shqiptar.

Bahri Beci u lind në Shkodër, me 6 mars të vitit 1936, në një familje me tradita atdhetare. Menjëherë pas mbarimit të studimeve universitare (1958) u emërua kërkues shkencor në Institutin e Gjuhësisë e Letërsisë, ku kreu detyra të rëndësishme drejtuese, përgjegjës sektori e drejtues projektsh, sekretar shkencor dhe drejtor.

Bahri Beci ishte anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (2008) dhe anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, përfaqësues i shkencës gjuhësore vendëse në redaksinë e përgjithshme të "Atlas Linguorum Europae" (ALE) dhe në disa organizma të tjerë shkencorë. Kërkues shkencor që nga viti 1958 në Institutin e Gjuhësisë dhe Letërsisë, menjëherë pas përfundimit të studimeve universitare; mbrojtëti doktoratën e parë në Paris me temën "Le système vocalique et consonantique du parler de la ville du Shkodra" / "Sistemi zanor dhe bashkëtingëllor i së folmes së qytetit të Shkodrës"; përfundoi disertacionin e shkallës së parë me studimin "Të folmet e gegërishtes qendrore" dhe disertacionin e dytë të doktoratës me studimin "Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i të folmes së Shkodrës". Drejtoi në pozicione të ndryshme institucionin ku u punësua, duke filluar nga detyra e sekretarit shkencor deri tek detyra e drejtorit. Veprimtaria e tij universitare shtrihet në disa vende, duke përfshirë Institutin e Gjuhëve dhe Qytetërimeve Orientale në Paris INALCO.

Fusha kryesore e veprimtarisë shkencore-kërkimore të Bahri Becit ka qenë historia e dialekteve dhe nëndialekteve të shqipes; proceset e konvergencës historike midis tyre; kushtet dhe ndikimet e krijimit të dallimeve mes toskërishtes e gegërishtes; periodizimi i zhvillimeve

dialektore në gjuhën shqipe: "Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre" (Tiranë 2002); "Struktura dialektore e shqipes" (Tiranë 2016); "Historia e formimit të strukturës dialektore të shqipes" (Tiranë 2019).

Brenda kësaj problematike vend qen-



dror zunë studimet dialektologjike për të folmet veriperëndimore dhe qendrore të shqipes (Shkodër, Dibër): "Të folmet veriperëndimore të gjuhës shqipe dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës" (Tiranë 1995); "Gegërishtja qendrore dhe grupimi i të folmeve të saj" (Tiranë 2007).

Pjesë e pandarë e kërkimeve të Bahri Becit në dialektologjinë historike dhe bashkëkohore janë kontributet e tij në drejtimin shkencor të veprës akademike "Atlas dialektologjik i gjuhës shqipe" (Napoli 2007), pjesë e korpusit të trashëgimisë shpirtërore të popullit shqiptar dhe për plotësimin e të dhënave të dialekteve të shqipes në "Atlasin Gjuhësor Evropian".

Bahri Beci mori pjesë si delegat dhe nënshkrues i Rezolutës së Kongresit të Drejtshkrimit (1972) dhe është autor i dy studimeve monografike për proceset njësuese dhe rolin e faktorëve shkencorë e joshkencorë në formimin e shqipes letrare të sotme, "Historia e standardizimit të shqipes" (Tiranë 2010) dhe "Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri" (Pejë 2000). Në kuadër të studimeve ballkanologjike të Bahri Becit, kushtuar pozicionit të shqipes në lidhjen gjuhësore ndërballkanike, të nxitura kryesisht prej kërkimeve krahasimtare në zhvillimin e dialekteve, veçohen veprat "L'union linguistique balkanique a la lumière des données de la langue albanaise" / "Lidhja gjuhësore ballkanike në dritë të të dhënave të gjuhës shqipe" (Tiranë 2020) dhe "Probleme të lidhjeve të shqipes me gjuhët e tjera ballkanike" (Pejë 2002).

Bahri Beci sintetizoi arritjet e punës së tij në vepra themelore me karakter normativ si "Gramatika e gjuhës shqipe,

për mësuesit e gjuhës shqipe" (Tiranë 1997, Prishtinë 1998, Prishtinë 2002); "Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë" (Shkodër 2000, Prishtinë 2001, Shkup 2004, Tiranë 2004) dhe "Fonetika e gjuhës shqipe" (Prishtinë 2004; Tiranë 2004).

Vepra shkencore e Bahri Becit karakterizohet nga sinergjia e studuesit në ekspeditë kërkimore dhe njëherësh në një proces formimi të thelluar bashkëkohor perëndimor. Kjo veprë, kjo trashëgimi, do të jetë gjithnjë një këshilltare e domosdoshme e brezave të rinj të studuesve. Miqtë, kolegët, bashkëpunëtorët, studuesit dhe studentët e tij të shumtë përlulen me nderim para kësaj veprë.

Në funksion të qëllimit të formimit të një brezi të ri studuesish Bahri Beci u dërgua për specializim në Paris, ku mbrojtëti doktoratën me temën "Le système vocalique et consonantique du parler de la ville du Shkodra" / "Sistemi zanor dhe bashkëtingëllor i së folmes së qytetit të Shkodrës".

Më pas, me kthimin në Tiranë, përfundoi disertacionin e shkallës së parë me studimin "Të folmet e gegërishtes qendrore" dhe disertacionin e shkallës së dytë me studimin "Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i të folmes së Shkodrës".

Veprimtaria universitare e Bahri Becit shtrihet në disa vende, duke përfshirë Institutin e Gjuhëve dhe Qytetërimeve Orientale në Paris INALCO.

Bahri Beci është anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (2008) dhe anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe i redaksisë së Atlas Linguorum Europae (ALE).

Fusha kryesore e veprimtarisë shkencore-kërkimore të Bahri Becit ka qenë historia e dialekteve dhe nëndialekteve të shqipes. Brenda kësaj problematike vend qendror zunë studimet dialektologjike për të folmet veriperëndimore dhe qendrore të shqipes (Shkodër, Dibër).

Profesor Beci ishte personalitet me veprimtari të shumanshme në disa fusha të gjuhësisë shqiptare historike e bashkëkohore për më shumë se gjashtë dekada; autor i dhjetëra veprave monografike dhe studimore në fushën e dialektologjisë, të fonetikës, të gramatikës, të rrugës së formimit të shqipes së njësuar, të historisë së gjuhës shqipe dhe të statusit të saj në lidhjen gjuhësore ballkanike.

Bahri Beci mori pjesë si delegat dhe nënshkrues i Rezolutës së Kongresit të Drejtshkrimit (1972) dhe është autor i dy studimeve monografike për proceset njësuese në formimin e shqipes letrare të sotme. Si studues në gjuhësinë ballkanologjike Bahri Beci ka lënë gjurmë me kontributet për pozicionin e shqipes në lidhjen gjuhësore ndërballkanike.

Bahri Beci sintetizoi arritjet e punës së

tij në vepra me karakter normativ. Vepra shkencore e Bahri Becit karakterizohet nga sinergjia e studuesit në ekspeditë kërkimore dhe njëherësh në një proces formimi të thelluar bashkëkohor perëndimor.

Botime:

a-Shkencore:

1-Të folmet veriperëndimore të gjuhës shqipe dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës, Tiranë: 1995;

2-Gramatika e gjuhës shqipe, për mësuesit e gjuhës shqipe, Tiranë: 1997, Prishtinë: 1998 dhe 2002;

3-Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, Shkodër: 2000, Prishtinë: 2001, Shkup: 2004; Tiranë: 2004

4-Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri, Pejë: 2000;

5-Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre, Tiranë: 2002;

6-Probleme të lidhjeve të shqipes me gjuhët e tjera ballkanike, Pejë: 2002;

7-Fonetika e gjuhës shqipe, Prishtinë: 2004; Tiranë: 2004;

8-Gegërishtja qendrore dhe grupimi i të folmeve të saj, Tiranë: 2007;

9-Historia e standardizimit të shqipes, Tiranë: 2010;

10-Struktura dialektore e shqipes, Tiranë: 2016;

11-Historia e formimit të strukturës dialektore të shqipes, Tiranë: 2019;

12-L'union linguistique balkanique a la lumière des données de la langue albanaise, Tiranë: 2020;

b-Përsiatje, ese, memuare:

1-Një libër që nuk do të doja ta shkruaja, Tiranë: 2013;

2-"Homo ideologicus" në shkencën shqiptare, Tiranë: 2015;

3-"Përrjetime" 1936-2021, Tiranë: 2021;

c-Bashkëautorësi:

1-Atlas dialektologjik i gjuhës shqipe, Napoli: 2007;

2-Atlas Gjuhësor Evropian, ALE;

3-Të mësojmë shpejt gjuhën shqipe (metodë për mësimin e shqipes nga të huajt, e botuar dhe ribotuar në gjuhët kryesore, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht etj.);

d-Libra shkollorë:

1-Abetarja "hap pas hapi", Tiranë: 2006-2020;

2-Seri të plota të librave të gjuhës shqipe për shkollat nëntëvjeçare (klasat II-IX) në Shqipëri (1970-2004, me bashkautorë), në Kosovë (2004-2020) dhe në Mal të Zi (2004-2020).

I shprehim ngushëllimet e të thella familjes e të afërmeve, anëtarëve të Asamblesë - familjes shkencore të tij - bashkëpunëtorëve të shumtë, studuesve dhe studentëve.

I përjetshëm kujtimi i akademikut Bahri Beci!

Shpresa Bajraktari-Ruçi

Një panoramë e shkurtër për Norvegjinë

Është vendi më verior i Evropës, vendi i ditës dhe natës polare. Ka një sipërfaqe 385.203 km² dhe një popullsi 5.328 milion banorë.

Norvegjia, që nga viti 1814 është mbretëri konstitucionale. Parlamenti përbëhet nga 169 deputet dhe, zgjedhjet parlamentare bëhen një herë në katër vjet.

Administrativisht vendi është i ndarë në 19 regjione (Fylke) dhe 426 komuna.

Norvegjia nuk është anëtare e BE dhe ka monedhën e vet.

Nga rreth 9.5 milion norvegjezë, vetëm 4.5 milion jetojnë në Norvegji. Shumë prej tyre jetojnë në [USA](#). Suedi, Danimark, Angli, Spanjë, Kanada, Australi, Holandë, Afrikën e Jugut, Brazil, Zelandën e Re, Rusi.

90 përqind e popullsisë janë vendas. Pjesa tjetër janë imigrantë nga Evropë dhe Afrika. Norvegjia e ka numrin më të vogël të banorëve për km/katror në Evropë, 14.7 banorë. Sipërfaqja e banimit është 1.7 përqind e teritorit. 37.4 përqind e sipërfaqes është pyje dhe, 3.5 përqind tokë e punueshme. Mbi 50 përqind e sipërfaqes është male të lartë, pllaja, kënetat, akullnaja. Mbi 20 përqind e sipërfaqes janë në lartësinë mbi 900 m. mbi nivelin e detit.

Banorët e parë në Norvegji u vendosën 9000 vjet para Krishtit. Kjo ndodhi në fundin Epokës së Parë të Akullit, kur regjioni u bë i banueshëm. Banorët e parë jetonin me gjueti kafshësh dhe peshku. Gjahu i tyre ishin kafshët si, fokat, kaprolli, dreri, balena. Punimi i tokës dhe mbarshtrimi i bagëtive filloi 500 vjet para Krishtit, në Epokën e Broncit. Kjo ishte periudha kur, shumë armë dhe prodhime dekorative do të mbanin emrin e banorëve vendas.

Wikingët janë një pjesë e lavdishme e historisë së Norvegjisë. Periudha e wikingëve zgjati nga viti 800 deri në vitin 1050 pas Krishtit. Gjatë kësaj periudhe, Wikingët, me anijet e tyre shumë të shpejta, të ndërtuara vetë, sulmuan Irlandën, Francën, Anglinë dhe Suedinë. Wikingët njihen si barbarë por, lavdia, nuk ishte qëllimi i vetëm i tyre. Ata njiheshin si prodhues mjetesh lundrimi, vegla pune, tregtare dhe administruese. Stolitë e prodhuara prej tyre, edhe sot mendohen mrekulli. Kombinimi i të gjitha këtyre talenteve, i bëri wikingët të njohur si luftëtarë të mëdhenj.

Ata krijuan disa shtete si, Dublin

dhe regjionet e Normandisë.

Megjithatë, koha e wikingëve përfundoi me ardhjen në pushtet të mbretit Harald III. Në vitin 1066, Hardrade provoi pa sukses, të pushtonte Anglinë.

Nëse do të udhëtoni në Norvegji, sigurisht që do të mrekulloheni nga kishat e veçanta, me çati shumë të pjerrëta prej druri. Ato janë një pjesë e trashëgimisë kulturore të vendit. Kishat u ndërtuan në Mesjetë, me material druri. Për nga arkitektura, janë komplet e kundërta e kishave tradicionale prej guri, të ndërtuara në Evropë.

Norvegjezët janë mjeshtër të përpunimit të drurit. Shtëpitë prej druri, janë të zbuluara me motive kafshësh si, pëlumbi, dreri, kaprolli, balona.

Kisha më e vjetër në Norvegji është ndërtuar në vitin 1150 dhe ndodhet në Urnes, afër Sognefjords. Ajo i takonte një familje shumë të pushtetshme.

Këto mrekulli arkitektonike gjenden në qytete të ndryshme të vendit, në Oye,

Hore, Lomen, Urnes und Rodal.

Norvegjia vetëm në vitin 1905 arriti përfundimisht pavarësinë e plotë. Ishte koha kur Haakon i VII mori kurorën mbretërore. Deri në atë kohë, vendi ishte një koloni e Danimarkës.

Pas shpalljes së pavarësisë, në vitin 1907, grave iu dha e drejta e votës, për zgjedhjet vendore. Në vitin 1913, iu dha e drejta edhe për zgjedhjet kombëtare.

Ja dhe diçka për Norvegjinë e sotshme:

Norvegjia, për nga natyra mendohet "Përbindshi" i botës dhe, për nga pasuria mendohet "parajsa" e botës.

Është vendi me terrenin më të thyer në botë, ka 1300 male të cilat përshkohen nga mbi 900 tunele të qarkullimit rrugor. Ka 25.148 km. bregdet, 450.000 liqene dhe 150.000 ishuj.

Edhe norvegët kanë bërë luftë, janë pushtuar dhe kanë pushtuar. E veçanta e popullit norveg është se, pas çdo lufte ata gjithmonë janë pajtuar, janë bashkuar dhe i janë turrur punës. Shquhen si njerëz



paqësorë, të mençur, të ditur dhe patriotë. Një gjë të tillë, e vërteton shumë mirë gjendja e tyre ekonomike. Norvegjia ka të ardhurat më të larta për frymë në botë:

Plot 81.995 US\$. Prodhimi vjetor bruto kap vlerën 550.11 mrd €

Po ne? Ku jemi ne, populli më i lashtë i Evropës! Ne nuk punojmë, grindemi. Grindemi para luftës, gjatë luftës dhe pas luftës. Norvegët nuk grinden kurrë, ne nuk pajtohemi kurrë. Në Norvegji nuk ka burgje, tek ne ndërtohen burgje dhe, megjithatë, krimi dhe korrupsioni nuk ndalen.

Në vitin 1989, viti i fundit i diktaturës komuniste, Shqipëria kishte 10 burgje me 5023 të burgosur. Popullsia mendohej rreth 4 milion banorë, i takon 125 të burgosur për 100 mijë banorë, shifër kjo nën mesataren e Evropës. Në këto tri dekada janë ndërtuar 24 burgje dhe janë rreth 6000 të burgosur. Popullsia llogaritet rreth 2.8 milion banorë. I bien rreth 214 të burgosur për 100 mijë banorë. Është shifra më e lartë në Evropë. Nëse llogarisim edhe shqiptarët që vuajnë dënimin në burgjet e Evropës, shifra mund të shkojë rreth 300-350 të burgosur për 100 mijë banorë. Rekord botëror. Vetëm në Angli, nga rreth 80 mijë shqiptarë që jetojnë aty, thuhet se, 1400 janë të burgosur, i takon 1750 të burgosur për 100 mijë banorë, rekord i panjohur në botë.

Përktheu Lekë Imeraj-shkrimtar, përkthyes, publicist



(vijon nga faqja 11) edhe në vlerësime të tilla, si ato që kanë shprehur ata që e njohin nga afër krijimtarinë dhe veprimtarinë e tij, si dramaturgu Fadil Kraja "Mjeshtër i Madh", i cili thotë: "...Kadri Ujkajn e çmoj, jo vetëm për librat e tij, që janë një realitet që duhet vlerësuar, por edhe për pjesëmarrjen e tij në të gjitha veprimtaritë letrare, që zhvillohen në Malësi të Madhe dhe në Shkodër, ku zëri i tij është prezent, zëri i tij dëgjohet, zëri i tij vlerësohet. Dhe, kjo është gjëja më e mirë e Kadri Ujkajt, për të cilat unë e çmoj." ("Të flasësh për Kadri Ujkajn", tv-Kopliku, më 12.05.2016).

Bashkoi vlerësimin tim me atë të prof. F. Krajës "Mjeshtër i Madh", prof. G. Uruçi, prof. as. dr. A. Osja", prof. dr. Z. Pergega, prof. dr. B. Baliu, prof. I. Mborrja, shkrimtares V. Allmuçaj, publicistit N. Baca dhe të tjerë, duke uruar gjithashtu që edhe libri i tij, më i ri, në prag botimi, "Dritëhijet tona si thelbi ynë", ndryshe një psikanalizë e thelbit tonë si genie, apo e shoqërisë njerëzore, kësaj radhe, një farë lloji, pjesërisht si një "histori e trevës sonë përmes esesh", siç e shpreh autori në kushtimin e këtij libri, të ketë pëlqimin e mjaft lexuesve e studiuesve të interesuar,

veçanarisht, për një njohje krejt ndryshe të Malësisë së Madhe dhe të bijve të saj të djeshëm e të sotëm. Sokrati i urtë thoshte se, "gjëja më e vështirë është të njohësh vetveten!"

Të ndjekësh dritëhijet e një bashkësie globale, kur i referohesh esesë "Dritëhijet e kapitalizmit global", apo dritëhijet kombëtare përmes esesë "Rrugëtimi ynë tragjik, ndryshe si fati i një populli të vogël si yni", sikurse dritëhijet e krahinës, me esenë "M. Madhe me dritëhijet e veta", e thënë siç është bashkësia shqiptare, me udhëtimin e saj, në rrjedhat e kohës të

cilat, herët apo vonë, do ta shpien në përfshirjen në Bashkësinë Evropiane, është pa dyshim edhe një akt sa i guximshëm dhe profesional, po aq kuptimplotë, sa edhe i rëndësishëm.

Urime i dashur Kadri për këtë ndihmesë të re, që ka edhe një titull ndjellës dhe kureshtar "Dritëhijet tona si thelbi ynë", i artikuluar si një zë origjinal kritik dhe eseistik në ditët tona!

Akademik Gjovalin Shkurtaç,
Tiranë, më 10 janar 2023

*** Poezi nga MIGENA ARLLATI *** Poezi nga MIGENA ARLLATI ***



Mesnatës së dimrit
dashuria struket shpesh
nën hi zjarresh

Mëngjeseve të ftohtë
zemra heshtur rreh
mjegullës së acartë

Ditës me dëborë
damarët ngjyrosin shpirtin
me të kuqtën fërfëllimë

Malli im dhe malli yt
rëndojnë më fort
se shtatë bjeshkë bashkë!

KËSHILLË TIM BIRI!

Shkoi dimri
Iku edhe një stinë...
Tim biri nuk i bien më këpucët e vjetshme
I duhen një palë të reja
Këmba e tij e vockël është rritur
Këmba e tij e vockël
që shkel mbi tokën e madhe,
tokën me miliarda njerëz,
njerëz dhe fatet e tyre
në këtë rruzull plot e plot fate

Këmba e tim biri
do t'hyjë nesër
në një këpucë më të madhe.
Do shkelë mbi tokën,
do ecë mbi botën...

Ki kujdes biri im,
sado të kesh këpucë të madhe
mos shkel mbi fate njerëzish,
ki mendjen të ecësh butë
të hapërosh ndjeshëm
me hapin tënd mbi botën
njerëz të mos shkelësh!
Në botën e madhe
lehtë – lehtë të ecësh,
me këmbën tënde
askënd të mos shkelësh!

NUK KANË ÇMIM POEZITË E MIA!

U shitën poezitë e mia
ca në panairë libri
ca në librari
sa në tenda
e sa në trotuare

I pashë fjalët tek u shpërndanë
në dhë e mbi dhë,
morën rrugët e botës
dhe ngarkuar mbi metafora
thithën ajër ngado

Cili është çmimi i librave me poezi?
Sa shifra ka ai?
Janë shumë të shtrenjta poezitë e mia
Aq të shtrenjta sa ngado shkoj
i shpërndaj si fjalë në podiume letrare
i dhuroj si vëllime në tryeza miqsh.
Le t'ia verë lexuesi vetë një çmim
dhe ai, qoftë i pari dhe i fundit vlerësim.

Le t'i shfletojë, t'i lexojë,
t'i gjuajë a dhurojë,
unë ia kam dhënë të gjitha të drejtat
që ai vet të bëjë si të dojë

Nuk kanë çmim poezitë e mia.
Aq të shtrenjta më janë ato!

MALL**LUTJE PËR DASHURINË**

Zot i madh e i vërtetë
Ty që me sy të kërkoj
sa herë yjet në qiell kundroj,
plotësoma një dëshirë
vetëm një dëshirë edhe pikë,
e mandej, pa u ndjerë,
nga kjo botë të ik, të ik

Zot i madh i lartësive
që bëre qiellin, tokën, detin,
Ty që me vete kudo të kam
dhe prapë askund nuk të gjej,
përmbushma të vetmen ëndërr
që nesër ta prek dhe kthej në çëndërr,
vetëm një herë edhe pikë
e mandej, pa bërë zë
nga kjo botë të ik, të ik

Zot i madh i times botë,
Zot i madh i fatit tim,
këtu në pëllëmbë të dorës ta kem
të voglën, të madhen dashuri,
atë që më dha të parën frymë
e më ndez pa ndalë në gji
nga i pari der' në t'përhershmin çast
e sërish mbetet dashuri,
po ajo qelizë që më krijoi mua
kur këtë jetë ma fale Ti!

Vetëm një dëshirë edhe pikë
dhe më pas, të ik, të ik,
me të voglën dashuri
me të madhin zjarr në gji
le të mbesë veç shkumb e hi!

ANTI

E pinte duhanin gjyshi im
Tymoste mbi mustaqet trashë-trashë,
ulur këmbëkryq në vatrën e flaktë
me cigarishten shtatë pashë.

E pinte duhanin im atë
fjollat e hirta në shtëllunga i rriteshin,
nga cigarja deri te metalurgjiku
mushkëritë me vello ngjyrë zi do t'i visheshin.

E pi duhanin edhe im shoq
me dy gishtat në buzë shtrëngon cigare e heshtje,
re qortimesh sa herë i dërgoj
fshihet në të nikotintën mjegull.

Po rritet si lis im bir,
me duart e mia shumë bekime ia dhashë,
por, në fytyrë do t'ia ndez flakë
nëse erën e duhanit në rroba ia pashë!

BASHKËSHORTË

Jemi përplasur
shpesh ka ndodhur kjo,

si dy ajsbergë që rrënojnë
në oqeanin e mërisë.
Përplasen, shtyhen
furtunë në të katër anët.
Bunacë e lehtë vjen e pason
lehtë në rërë tallazet pajton

Jemi shkëndijur
si dy gurë stralli,
nga përpjekja
tym inatesh na ka mbirë në ballë,
jemi përmbytur
në breg sërish na ka nxjerrë tjetra valë

Në folenë tonë mbi shkëmb
me copëza balte lidhëm fije bari,
si dallëndyshja të vegjëlit ushqen
krijesat tona t'i ngrohë një diell

Në luftën e nxehtë
Në luftën e ftohtë
Nga moti në mot
Sërish bashkëshortë!

“DHUNË” GRUAJE

(alegori)
Unë e dhunoj.
Mëngjes, drekë, darkë
çdo ditë e kohë pa kohë.
Ai është i përdhunuari im.
Me dy duart e mia
shtrëngoj e shkumoj,
lodhem sot
vijoj nesër sërish,
dhunë e vijueshme
pason tjetrën ditë

Përkulem mbi të
si një dallgë e ngrirë,
Rëndojnë duart e mia
flakërojnë në të katër anët,
Filloj mërmëris
tregoj pa fund histori,
shfryhem para shurdhërisë
për fajin e mbetur jetim,
me britmë të heshtur
rrëfhem për sekretet fshehur,
i kthehem sërish me më shumë inat
pyes: pse vallë këtë fat?!

Djersij, ofshaj
lotoj, buzën kafshoj
të gjitha shkuma e tij i mban,
sa herë i jam pranë
sërish e dhunoj
me gojë nuk bëzan
shyqyr që s'ka gojë

I gjori lavaman,
Veç ai dhunën time mban!

ORËT

Orët e jetës sime
nisin atje ku mbarojnë

Orë të zgjatura tërkuzë
Orë të shtyra me zor
Orë të pritura me anktë
Orët e orëve të ditës

Diku më duket se ka ngecur akrepi,

atje tek orë e seminarit.
Orët e prishura duhen ndrequr,
orë që prishen e ndreqen sërish
për t'u prishur e mos u ndrequr më kurrë!

GJETHE VJESHTE

Sa shumë gjethe ranë
mbi dy shpirtra të zhveshur
atje lart mbi kodër

Qielli vjeshtor zgjati rrezet në ajër,
krahët e erës shkundën fletë nga degët
dhe pemët u mpleksën në tokë
në mijëra, miliona gjethe

Ato u bënë humus
për dashurinë që mbollën ata të dy!

HAIKU

Sytë e mi
zhytur në sytë e tu
bashkë me shtatë rrathë liqenesh

Buzët e tua
mbytur në buzët e mia
mes ujëvara shushurimash

Vështrimi yt
buzëqeshja ime
reflektuar në rreze diejsh.

NINULLË E RE!

(ArGenit)
Tani,
ti zogth i njomë
cicëron jetën time.
Duart e mia u drodhën
që herën e parë kur të mora,
të ngrita në ajër
me zemër të bekova,
qiellit me dy sytë
me gjithë qenien time
për ty i lutem,
për mijëra bekime...

Të dëgjoj si qan,
një simfoni jete jehon,
shpirtin më mbush përjetësi
dhe krahët tërë botën zaptojnë,
gishtërinjtë drithërojnë
kur mbi faqe të lëmojnë lehtë,
lëkura e njomë
tek unë aromë jete sjell,
je mishi e gjaku im
që vlon nëpër dej

Kur në prehër të mbaj
botën thua se zaptoj,
frymëmarrje imja
ti frymon njësoj,
një engjëll,
një dritë e re tek unë sot
fillon jeton,
më mbush plot

Je sot e nesër,
përgjithmonë,
një bir që nënën e tij gëzon!
Në duart e mia,
një zemër e vockël rreh,
një ninullë e re,
një gen i artë ti je!

Shkrimtari Lazër Stani



Shkrimtari Lazër STANI, lindur më 17 janar 1959, i biri i Palit dhe Katrinës, në fshatin Gjuraj, të krahinës së Pultit, Dukagjin, është njëri nga prozatorët tanë bashkëkohor të shquar. Me përmbledhjet me tregime që i botoi deri më sot ai e ngriti prozën tonë në nivelet më të larta poetike. Të këtyllë e vlerësuan studiuesit dhe kritikët tanë letrarë më të njohur.

Në vitin 1985 u diplomua në Fakultetin e shkencave të natyrës në Tiranë, në degën biologji-kimi. Prej asaj kohe u mor me letërsi dhe gazetari, eseistikë dhe kritikë letrare. Tregimet e para i botoi në fillim të viteve nëntëdhjetë në gazetën "Drita", organ i Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve dhe në "Zëri i rinisë", gazetë që në ato vite botonte dhe krijime të avangardës.

Tregimet e këtij autori u përkthyen në anglisht, gjermanisht, italisht, maqedonisht, serbokroatisht e të tjera.

Deri tani ka botuar këto vepra:

* Në vitin 1993, "Misteri i hijeve", vëllim me tregime, Shtëpia Botuese të LSHA-së

* Në vitin 1995, "Shplakja e Santa Marisë", vëllim me tregime, Shtëpia Botuese "Eurorilindja"

* Në vitin 1995, "Me dymbëdhjetë çelësa", libër me përralla dhe legjenda të Veriut, Shtëpia botuese e LSHA-së

* Në vitin 1998, "Në Bregenc shkohet për të vdekur", vëllim me tregime, Shtëpia botuese "Albinform"

* Në vitin 1999, "Feniksi i kuq", vëllim me tregime, Shtëpia Botuese, "Buzuku", Prishtinë

* Në vitin 2005, "Dënesje në dru", Shtëpia botuese "Ideart", Tiranë

* Në vitin 2014 "Kohë për nuse", botim i E. B. Fishta

* Në vitin 2016 "Rrugë pa krye" - ese

letrare. E. B. Fishta

Në vitin Lazër Stani është nderuar me çmime të ndryshme letrare, ndër më të rëndësishmet:

*Çmim kombëtar për librin e parë më të mirë me tregime botuar në vitin 1993. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

*Çmimin e vitit për librin më të mirë të botuar nga Shtëpia botuese "Eurorilindja" 1995.

*Çmim kombëtar për librin më të mirë me tregime botuar në vitin 1996.

*Çmimin "Anton Pashku" për librin më të mirë me tregime botuar në vitin 2018.

*Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me nr. 154, me 10 maj 2013, në kuadrin e 10- vjetorit të themelimit të Saj.

I.

TREGIMTAR I VLERA VE TË MËDHA POETIKE

Shkrimtarin Lazër Stanin, si dhe shkrimtarët e mëdhenj, e veçon stili që përdor në krijimin e tregimeve, bota poetike që e përfiton dhe e shqipton me anën e strukturës gjuhësore. Shkrimtarët si ai mund t'i kopjosh, por jo edhe t'i imitosh për arsye se veprat e tyre janë fryt i pasurisë shpirtërore, i dijes, i aftësisë dhe i shkathtësisë së veçantë krijuese. Ata janë burimorë për qasjen dhe shqiptimin e botës e të temave që trajtojnë, janë të mëvetësishëm për sistemin e të shprehurit, për natyrshmërinë e shqiptimit dhe të përfimit të veprës si tërësi (unitet) strukturash, për kuptimet e shumta e të rëndësishme që dalin prej tekstit të saj. Me një fjalë, shkrimtarët e tillë janë të mëdhenj për shkak se janë të vetvetes dhe se në veprat e tyre përligjin mëvetësinë shpirtërore, nëpërmjet së cilës ia dalin t'i vërejnë dhe t'i zbulojnë dukuritë e botës e të shpirtit të njeriut dhe si art t'ua ofrojnë të tjerëve; kanë çka i thonë tjetrit dhe ia thonë bukur. Duke e thënë bukur atë që duan t'ua thonë edhe të tjerëve, ata krijojnë artin e tyre të madh, artin që i dallon nga të tjerët dhe i bën të pavdekshëm. Lazër Stani me përmbledhjet e tij me tregime hyn në radhën e këtyre shkrimtarëve. Këtë aftësi dhe artin e tij letrar poetik e ka dëshmuar qysh me tregimin "Njeriu i dosjes" të botuar në korrik të vitit 1989.

Këto cilësi krijuese Lazër Stani i ka përligjur në përmbledhjet e tij me tregime "Misteri i hijeve", "Shplakja e San-

ta Marisë", "Në Bregenc shkohet për të vdekur" e të tjera.

Më përfaqëton po ndalemi në dy përmbledhjet e fundit "Dënesje në dru" dhe "Koha për nuse"

II.

PËRMBLEDHJA "DËNESJE NË DRU"

Tregimet e botuara në vëllimin "Dënesje në dru" cilësohen me rrëfim burimor e të mëvetësishëm, me çka Lazër Stani dallohet nga prozatorët tanë paraprakë dhe ata bashkëkohorë. Kjo burimësi dhe mëvetësi vërehet në përbërës të qenësishëm të krijesës letrare artistike: qasja sa e veçantë aq edhe e natyrshme e objektit artistik, trajtimi dhe shqiptimi kompleks i dramës (dramatikes) së botës shpirtërore të njeriut; shtresimet – mbindërtimet rrëfimorë të veçanta dhe të papërsëritshme, që ndërliken e kush-tëzohen natyrshëm mes veti; mjeshhtëria e ngjizjes së shtresimeve të shumta e të ndryshme të rrëfimit dhe mënyra e të shprehurit, që mbërrihet nëpërmjet rrafshëve të ndryshme të rrëfimit cilësor. Lazër Stani është i lidhur ngushtë me botën poetike që e përfiton si strukturë gjuhësore, si mesazh poetik. Përfimi i tregimit nga ai, si akt krijues, është për të "një ankth dhe tronditje e brendshme që kërkon të shfaqet, të shndërrohet në fjalë." Pikërisht në procesin e krijimit ai e ndien qenësinë dhe plotninë e vet si krijues; e ndien dhe është në gjendje ta shprehë atë nëpërmjet artit: "Të shkruarit është gjendja ime më e mirë." Pra, në tregimet e veta autori përmbush atë që e ka thënë edhe vetë: "Thjeshtë, në librat e mi dua të jem vetvetja."

Në tregimet Stani përdor një strategji të mëvetësishme të rrëfimit, nëpërmjet së cilës bëhet gërmimi në rrafshin thellësor i botës konkrete dhe i botës së brendshme të personazheve. Thellësinë e vëzhgimit ai e përligj sidomos në shqiptimin e marrëdhënieve midis dy gjinive: mashkullit e femrës ose më drejt nëpërmjet ndjenjës së dashurisë. Duke ballafaquar këto botë dhe marrëdhëniet midis tyre në tregime shpalosen ndjesitë shtresat më të fshehta të shpirtit të njeriut. Për këtë arsye njohësi i mirë i krijimtarisë së Lazër Stanit së ka vështirë ta dallojë tregimin e tij edhe kur ai nuk është i nënshkruar me emrin e autorit.

Shqiptimi i jetës dhe i botës së brendshme të njeriut në tregimet e Stanit bëhen kryesisht mbi bazën e ëndrrës, ku dukuritë shfaqen të ndërliken në rrafshë e në mënyra të ndryshme e të shumta; ato përafrohen dhe bashkekzistojnë edhe kur i ndan koha, vendi, hapësira, edhe kur janë në pajtim ose në kundërshtim të plotë.

III.

PËRMBLEDHJA "KOHË PËR NUSE"

Përmbledhja "Kohë për nuse", që vjen 10 vjet pas asaj "Dënesje në dru", dëshmon një rrafsh kulmor të artit poetik të Lazër Stanit, po dhe të tregimit bashkëkohor shqiptar në përgjithësi. Në të ai nuk emiton autorë të tjerë, pra s'ka një shkrimtar model të caktuar, po edhe brenda krijimtarisë së vet tregimtare është i ndryshëm. Stani gjurmon pareshtur mënyra të veçanta të qasjes së objektit artistik dhe të ndërtimit – shtjellimit të rrëfimit, përkatësisht të tekstit, të pasurimit të perceptimit e të sistemit shprehës poetik, që është cilësi e shkrimtarëve të mëdhenj. Vetëm shkrimtarët që veprojnë në këtë mënyrë, përligjin ekzistimin e veprave të tyre jo vetëm në të tashmen, po edhe në kohët e ardhshme. Me një fjalë, Lazër Stani e pasuron vijimisht tregimin e vet në rrafshin artistik për arsye se ajo që i jep shpirt krijesës letrare poetike është mënyra e të thënë, përkatësisht të thënë bukur dhe shumësia kuptimore që përligjet përmes strukturës gjuhësore poetike, tekstit konkret. Teksti që gjakon dhe dëshmon njëkuptimësinë, i përket fushave të tjera, jo letërsisë së mirëfilltë.

Mënyra e ndërtimit të tregimeve të Lazër Stanit të përkujton atë që thoshte Jurij Lotman: "Teksti artistik nuk është, thjesht, realizim i normave strukturore, por edhe i shkëlqes së tyre. Ai funksionon në fushën dyfish të strukturuar, e cila përbëhet nga tendencat e realizimit të ligjësisë dhe të shkëlqes (rrënim) të tyre. Edhe pse secila prej këtyre tendencave synon që ekskluzivisht të mbretërojë dhe ta anulojë të kundërtën, fitorja e cilësdo prej tyre është shkatërruese për artin. Jeta e tekstit artistik shprehet në ngritjen e tyre të ndërsjellë". Për këtë arsye vëllimi "Kohë për nuse" hyn në rrethin më të ngushtë të përmbledhjeve më të ngritura të tregimeve të letërsisë sonë.

IV

ESE TË RËNDËSISHME LETRARE



Aftësinë e vet krijuese Lazër Stani e dëshmoi dhe në fushën e kritikës, sidomos të eseistikes. Vëllimi me ese letrare "Rruga pa krye" është prova më e mirë që përligj dijen e tij sa të gjerë aq dhe të thellë për letërsinë, për veçantitë e saj, për shijen që ka krijuar dhe për prirjen që gjithë këtë dije dhe përvojë ta zbatojë në krijimin e prozës, përkatësisht të tregimit. Në të vërtetë, pjesë të eseve, që cilësohen me gjuhën poetike, i afrohen shumë prozave të mirëfillta artistike.

Mënyra e vëzhgimit dhe e dukuritë ndriçimit të dukurive të ndryshme në një varg esesh dëshmon se Stani përmes leximit ka përvetësuar një dije të madhe nga kryeveprat e letërsive të popujve të ndryshme. Kjo vërehet të thuash në secilin prej esëve të botuar në vëllimin "Rruga pa krye".

Me tregimet e Lazër Stanit proza jonë tregimtare (bashkë me tregimet e Koliqit, Kutelit, Pashkut, Y. Shkrelit e të tjerë.) bëhet prozë, letërsi e madhe. Letërsitë e mëdha i bëjnë vlerat, jo numri i atyre që i flasin gjuhët me të cilat ato përftohen.

Lazër Stani me të drejtë çmohet si njëri ndër tregimtarët tanë të mirë, i cili me veprat e veta e pasuroi dhe e ngriti prozën tonë shqipe në disa nivele, në një rrafsh të lartë poetik.

Lulash Brigja



*** Poezi nga PRELË MILANI *** Poezi nga PRELË MILANI ***

HELENA PELLAZGE TROJANE?!

Super emblemë bionde
e zbehtë si mermeri,
flokët e arta me onde
mbi supe fjogë ylberi

Vdekatare engjëllore
ëmbëltore dashurie
gjitha hire femërore
përmbi shat i bënin hije.

Një gërnjare magjepstare
si drite e vetëtimshme
gjysmë-nudo flakatare
stuhi rebele përpijshme.

Një viktimë delikate
e dëshirës të të tjerëve
lozonjare fluturake
që u kalli zjarrin djeve!

Helena luajti me zjarret
mes tyre u përvëlua
detit i'a mori valët
edhe zjarri nuk ju shua .

O ç' hijeshi ideale,
po dhe më i mundshmi portret
bukuria me fatale
e kënduar mijëra vjet.

Gruaja që flet Homeri
veshur me areolë magjie
veç për të lindte dielli
dhe nata me terr me hije!

Dy mbretër pellazgo-Ilir
luftuan për Trojën a ty?
Paridin¹ more me dëshirë
Menelaun² e le në vetmi

Jo, mor jo ta hajë dreqi
le seç të përfolën për zi
Ti s'që shkaku, por preteksti
dhe gjithë faj të mbeti ty .

Çmenduri Troja u shua
tmerr tragjizëm lashtësie
faji jetim u quajt grua
si tradhtare dashurie.

Pra Hektori e Patrokli
Akili me Odisenë
U lavdëruan mot pas moti
se me gjak përmbytën dhenë

Homeri e Euripidi
mallkuan dashninë tande

¹ *Paridi* - i biri i Priamit, mbretit të Trojës dhe bashkëshortes së tij, Hekubës, shkakuar i luftës së Trojës

² Menelau - i biri i Atreut, mbretit të Mikenës dhe bashkëshortes së tij Europës, mbret i Spartës. Menelau është një nga figurat qendrore të epeve të Homerit: si burrë Helenës për shkak të së cilës shpërtheu lufta e Trojës edhe më tepër si njeri që nxiti këtë luftë drejtpërdrejt. As mot, as sot e as kush nuk e mallkoi pasi sipas kodit maskulist ka vepruar në pajtim me kërkesat e së drejtës ndërkom-bëtare dhe të nderit të burrit.

Tisia³ Ovidi, Eskili:
të kryqëzuan o Trojane

Trofe burrash lufta mbeti
në kohë të vjetër e të re
ari gratë e pushteti
shytuan botën me rrufe.

Më të bukurën në botë
këmbë lehtë krahë flutur
ju thaftë goja kush e thotë
se Helena qe një bushtër!

Homer bobo ashtu ç' fole,
apo the se duhej thanë
ndaj dy sysh bre u verbove
se të mallkoj e lumja zanë!

Dritën tënde mori dielli
engjëllore moj shejtane
plis të bardhë si kupë qielli
iris pellazge trojane.

Është Helenë pak çdo femër
Helenën nëse kërkoni
mos u bëni pas me zemër
ja ku është po ta doni!
Në çdo shkelje dashurie
dhe pasione pa shpjegim
në gëzime lumturie
e katastrofa plot tërbim!



³ *Stesicore*: Poet i lashtë grek me pseudonimin *Tisia* në vitin 630 (p.es), pasi përfundoi veprën "Palinodia" përsëriste idenë e Homerit se Helena e tradhtoi Menelaon duke quajtur grua te përdalë Euripidi: Në tragjedinë Trojanet (e viti 415 para e.s.) e gjykon, duke menduar se i është shmangur dënimit edhe pse ka qenë shkas i shkatërrimit të Trojës.

Homeri: Pat shkuar edhe më tej duke quajti "bushtër Eskili:Te tragjedia "Agamemnoni",e përshkruan Helenën si grua e shumë burrave ,vrasëse të heronjve, shkatërruese të Trojës .

Ovidi: Poeti romak në librin "Heroides "me 21 letra imagjinare dashurie, të grave të famshme ,përfshinë edhe një letër të Helenës për Paridin ku thoshte "Do të doja të kisha ardhur më shpejt,atëherë kur virgjëria ime kërkohet nga 1000 meshkuj .Po të kasha parë ty,ti do kisha qenë i pari i njëmijëve

REDAKSIA

Kryeredaktore: LUIGJ SHYTI

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi Botimin:
ALEKS MARTIN BARDHOJA

